



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 150

Tiranë – E martë, 17 tetor 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 107/2023, datë 12.10.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 34/2022, “Për ngritjen e Nënkomisionit për Zhvillim të Qëndrueshëm në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financat”.....	16291
Vendim i Kuvendit nr. 108/2023, datë 12.10.2023	Për disa ndryshime në vendimin nr. 66/2021, “Për zgjedhjen e Byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit”, i ndryshuar.....	16291
Vendim i Kuvendit nr. 109/2023, datë 12.10.2023	Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për trajtimin e të dhënave personale në bazat e të dhënave shtetërore”.....	16291
Vendim i Kuvendit nr. 110/2023, datë 12.10.2023	Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e komisionit hetimor për kontratat publike në sektorin e shëndetësisë”.....	16292
Vendim i Kuvendit nr. 111/2023, datë 12.10.2023	Për mosmiratimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 48/2022, të Kuvendit të Shqipërisë, ‘Për përbërjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore’”.....	16292
Rezolutë e Kuvendit datë 12.10.2023	Për Kosovën.....	16292
Dekret i Presidentit nr. 287, datë 11.10.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16293
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 571, datë 11.10.2023	Për miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – Tema: Zonat Ekologjike”.....	16293
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 572, datë 11.10.2023	Për miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – Tema: Shpërndarja e Specieve”.....	16328

Urdhër i Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar nr. 315, datë 12.10.2023	Për delegim të përkohshëm të kompetencave.....	16375
Urdhër i ministrit të Infrastruktues dhe Energjisë nr. 123, datë 10.10.2023	Për miratimin e rregullores “Mbi një metodë të përbashkët të sigurisë për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për marrjen e autorizimit të sigurisë hekurudhore”	16375
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 40, datë 14.9.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1907 (285), datë 12.7.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	16384
Vendim i Komisionit të Votimit në Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve nr. 1, datë 9.10.2023	Për shpalljen e kandidatëve fitues për anëtarë gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.....	16391
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 360/12, datë 12.10.2023	Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 657, datë 8.10.2014, për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Qukës–Pogradec–Qafa e Plloçës”, i ndryshuar.....	16392

**VENDIM
Nr. 107/2023****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 34/2022, “PËR NGRITJEN E
NËNKOMISIONIT PËR ZHVILLIM TË
QËNDRUESHËM NË PËRBËRJE TË
KOMISIONIT TË PËRHERSHËM
PARLAMENTAR PËR EKONOMINË
DHE FINANCAT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Në pikën III të vendimit nr. 34/2022, “Për ngritjen e Nënkomisionit për Zhvillim të Qëndrueshëm në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financat” bëhet ky ndryshim:

“Zonja Milva Ekonomi caktohet anëtare dhe njëkohësisht kryetare e Nënkomisionit për Zhvillim të Qëndrueshëm.”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 12.10.2023.

**VENDIM
Nr. 108/2023****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 66/2021, “PËR ZGJEDHJEN E
BYROSË DHE PËRBËRJEN E
SEKRETARIATEVE TË KUVENDIT”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Në pikën II të vendimit nr. 66/2021, “Për zgjedhjen e Byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

“Zonja Blerina Gjylameti zgjidhet sekretare për Buxhetin.

Zoti Bledar Çuçi zgjidhet sekretar për Marrëdhëniet me Jashtë.”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 12.10.2023.

**VENDIM
Nr. 109/2023****PËR MOSMIRATIMIN E
PROJEKTVENDIMIT “PËR NGRITJEN
E KOMISIONIT HETIMOR TË
KUVENDIT PËR TRAJTIMIN E TË
DHËNAVE PERSONALE NË BAZAT E
TË DHËNAVE SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për trajtimin e të dhënave personale në bazat e të dhënave shtetërore”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 12.10.2023



**VENDIM
Nr. 110/2023**

**PËR MOSMIRATIMIN E
PROJEKTVENDIMIT “PËR NGRITJEN
E KOMISIONIT HETIMOR PËR
KONTRATAT PUBLIKE NË SEKTORIN
E SHËNDETËSISË”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe
nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen
e komisionit hetimor për kontratat publike në
sektorin e shëndetësisë”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 12.10.2023.

**VENDIM
Nr. 111/2023**

**PËR MOSMIRATIMIN E
PROJEKTVENDIMIT “PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 48/2022, TË KUVENDIT TË
SHQIPËRISË ‘PËR PËRBËRJEN E
KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR PËR REALIZIMIN E
REFORMËS ZGJEDHORE”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës,
nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektvendimit “Për një
ndryshim në vendimin nr. 48/2022, të Kuvendit të
Shqipërisë ‘Për përbërjen e Komisionit të Posaçëm

Faqe | 16292

Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 12.10.2023.

REZOLUTË

Në përputhje me angazhimet kushtetuese të
Republikës së Shqipërisë dhe politikën e mbrojtjes
së interesave strategjike kombëtare të përbashkëta
midis Shqipërisë dhe Kosovës;

Në përkrahje të sovranitetit dhe integritetit
territorial të Republikës së Kosovës dhe institu-
cioneve të saj kushtetuese, si dhe të përpjekjeve për
mbrojtjen e vlerave demokratike, sigurisë dhe paqes
në Kosovë dhe në rajon;

Thellësisht të shqetësuar për situatën e krijuar në
Republikën e Kosovës pas sulmit të organizuar
ushtarak dhe kriminal të një njësie terroristësh serbë
në veri të vendit, në datën 24 shtator 2023,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:**

Mbështet plotësisht dhe njëzëri rezolutën nr. 08-
R-009 të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
miraturar në seancën plenare të datës 28 shtator 2023;

Kërkon nga institucionet kushtetuese të
Republikës së Shqipërisë që në të gjitha instancat
ndërkombëtare, sikurse edhe në kontaktet bilaterale
me partnerët tanë, të angazhohen fuqimisht dhe të
ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për
mundësimin e një hetimi ndërkombëtar lidhur me
aktin terrorist në veri të Kosovës;

Inkurajon qeverinë e Republikës së Kosovës që
të punojë krah për krah dhe të bashkohet pa rezerva
me aleatët e saj strategjikë, Bashkimin Evropian dhe
Shtetet e Bashkuara të Amerikës në funksion të
procesit për arritjen e një marrëveshje përfundimtare
për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës
dhe Serbisë dhe njohjen përfundimtare të Kosovës
prej saj.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 12.10.2023.

**DEKRET****Nr. 287, datë 11.10.2023****PËR DHËNIE TË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, nenit 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Eniss Veton Shabani
2. Dion Ekrem Berisha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

VENDIM**Nr. 571, datë 11.10.2023****PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT
“STANDARDET SHQIPTARE PËR
SPECIFIKIMET TEKNIKE TË
INFORMACIONIT GJEOPHAPËSINOR
NË SHQIPËRI – TEMA: ZONAT
EKOLOGJIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 2, shkronja “v”, e 16, pika 1, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit

gjeohapësinor në Shqipëri – Tema: Zonat ekologjike”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin e përditësimin e të dhënave gjeohapësinore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

**STANDARDET SHQIPTARE
PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË
INFORMACIONIT GJEOPHAPËSINOR NË
SHQIPËRI
– TEMA: “ZONAT EKOLOGJIKE”****PËRMBAJTJA****1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE****2. HYRJË****2.1. Qëllimi****2.2. Si lexohet dokumenti****2.3. Detyrimet ligjore****2.4. Fusha e veprimit****3. TEMA****3.1. ZONAT EKOLOGJIKE****3.1.1. Parathënie****3.1.2. Terma dhe përkufizime**

3.1.3. Skemat e aplikimit dhe diagrami UML për temën “Zonat ekologjike”

3.1.4. Katalogu i tipologjive**3.1.4.1. Zonat ekologjike****3.1.4.2. Vlerat e klasifikimit të bimësisë natyrore**

3.1.4.3. Vlerat e klasifikimit të Direktivës së Kornizës së Strategjisë Detare

3.1.4.4. Vlerat e klasifikimit të shtresëzimit mjedisor

3.1.4.5. Vlerat e klasifikimit të zonave

3.1.4.6. Vlerat e klasifikimit të zonave ekologjike Emerald dhe Natura 2000

3.1.4.7. Vlerat e nivelit të klasifikimit të zonës**3.1.4.8. Vlerat e skemës së klasifikimit të zonës**

3.1.4.9. Vlerat e klasifikimit të zonave ekologjike të Direktivës së Kornizës së Ujit

3.2. Metadata**3.3. Kodi EPSG për KRGJSH-në****3.4. Cilësia e të dhënave**



3.4.1. Përputhja logjike – Përputhja konceptuale
(*Logical consistency – Conceptual consistency*)

3.4.2. Përputhja logjike – Përputhja me domeinin
(*Logical consistency – Domain consistency*)

4. ANEKSE

4.1. Aneksi A – Katalogu i tipologjisë

4.2. ANEKSI B – Kodlistat

4.2.1. Skema e aplikimit për temën “Zonat ekologjike”

4.2.1.1. Vlerat e klasifikimit të bimësisë natyrore

4.2.1.2. Vlerat e klasifikimit të Direktivës për Kornizën e Strategjisë Detare

4.2.1.3. Vlerat e klasifikimit të shtresëzimit mjedisor

4.2.1.4. Vlerat e klasifikimit të zonave

4.2.1.5. Vlerat e klasifikimit të zonave ekologjike Emerald dhe Natura 2000

4.2.1.6. Vlerat e nivelit të klasifikimit të zonës

4.2.1.7. Vlerat e skemës së klasifikimit të zonës

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

Ky dokument përmban standardet e specifikimeve teknike të të dhënave gjeohapësinore për ndërtimin e NSDI-së. Autori i këtij produkti është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), e cila është autoritet publik përgjegjës, për temën “Zonat ekologjike”.

Data e publikimit të versionit nr. 1 është Qershor 2020. Emërtimi i dokumentit është: ASIG_Standard_NSIDI_2020_ZE_v.1, ku:

ASIG – Autoriteti përgjegjës për krijimin e standardit

Standard – Lloji i dokumentit

NSDI – Qëllimi i dokumentit

2020 – Viti i krijimit

ZE – Tema për të cilën është krijuar standardi “Zonat ekologjike”, i referohet temës “Bio-geographical Regions” së direktivës INSPIRE

v.1 – Numri i versionit të standardit

2. HYRJE

2.1. QËLLIMI

Ky dokument përcakton specifikimet teknike, për të dhënat gjeohapësinore të temës “Zonat ekologjike”, temë e cila është përcaktuar në nenin 11, pika 2/v, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin

dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

Ky dokument publikohet si standard që përcakton rregullat bazë të implementimit të NSDI-së¹ në Shqipëri, me qëllim përdorimin e tij nga autoritetet publike përgjegjëse, për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor, që të arrihet një kuptueshmëri unike dhe korrekte e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore, për të realizuar ndërveprueshmërinë midis tyre.

2.2. SI LEXOHEJ DOKUMENTI.

2.2.1. STRUKTURA E DOKUMENTIT

Ky dokument është i organizuar në katër kapituj kryesorë:

1. Përshkrimi i standardeve – Në këtë pjesë jepet emërtimi dhe autori i standardeve.

2. Hyrje – Në këtë pjesë jepen përshkrime dhe shpjegime për të kuptuar mënyrën si organizohet i gjithë informacioni dhe si mund të interpretohet më lehtë ai.

3. Tema – Në këtë pjesë jepen specifikimet teknike për temën “Zonat ekologjike”.

4. Aneks – Në këtë pjesë jepen informacione shtesë, shpjeguese, në ndihmë të përdoruesve.

- Përmbajtja e kapitullit të 3-të është strukturuar në 4 pjesë kryesore:

3.1. Përshkrimi i temës – Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e temës dhe si është e ndarë kjo temë.

3.2. Metadata – Këtu jepen specifikimet teknike për metadatat e temës përkatëse.

3.3. Sistemi Koordinativ Referencë – Këtu përcaktohet sistemi koordinativ referencë (KRGJSH).

3.4. Cilësia e të dhënave – Këtu jepet një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementeve dhe matjes së tyre.

2.2.2. DIAGRAMET UML DHE KATALOGU I TIPOLOGJIVE

Diagramet UML ofrojnë një mënyrë të shpejtë për të parë elementet kryesore të specifikimeve dhe të marrëdhëniet ndërmjet tyre. Përkufizimi mbi llojin e objektit gjeohapësinor, atributet dhe marrëdhëniet janë të përfshira në Katalogun i Tipologjive (Feature Catalogue). Personat të cilët

¹ NSDI – Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Gjeohapësinor.



kanë ekspertizë tematike, por nuk janë të familjarizuar me UML-në, mund ta kuptojnë plotësisht përmbajtjen e modelit të të dhënave duke u fokusuar te Katalogu i Tipologjive. Për përdoruesit e aplikacioneve, Katalogu i Tipologjive mund të jetë i dobishëm për të kontrolluar nëse ai përmban të dhëna të nevojshme për përdorim.

Në tabelat e mëposhtme shpjegohet përmbajtja dhe mënyra e organizimit të informacionit, në tabelat e të dhënave, në Katalogun e Tipologjive.

Tabelat nr. 1, 2, me anë të shembujve, shpjegojnë mënyrën e organizimit të informacionit, në tabelën e tipologjive dhe të attributeve të tyre.

Tabela nr. 3, me anë të një shembulli, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit, në tabelën e kodlistës.

Tabela 1

EMRI - Emërtimi i tipologjisë	
Përkufizimi	Përkufizimi për tipologjinë
Përshkrimi	Shënime dhe përshkrime të tjera për tipologjinë
Lloji i tipologjisë	Tipi i elementit që mund të jetë i këtyre llojeve: «FeatureType» - një element që mund të jetë real, në terren, apo një dukuri abstrakte. «DataType» - një element tabelor, që shërben vetëm si tabelë attributesh, për t'u lidhur me një element tjetër «Enumeration» «codeList» - listë e parapërgatitur vlerash, ku elementi duhet të marrë vlerë. <i>Enumeration</i> nënkupton “renditje vlerash”, ndërsa <i>codeList</i> nënkupton listë vlerash ose ndryshe “kodlistë”. Në dokument gjenden të shqipëruara si “Numërtimet dhe kodlistat”. «Union» - një mbulesë topologjike e dy ose më shumë grupeve të të dhënave gjeohapësinore, që ruan tiparet, të cilat bien brenda shtrirjes gjeohapësinore të dy grupeve të të dhënave hyrëse. «Imported» - të dhëna të specifikuar në tema të tjera të direktivës INSPIRE. Në dokument gjenden të shqipëruara si “Të dhënat e importuara”
Gjeometria	Gjeometria e elementit sipas formatit vektor mund të gjendet në tri forma: pikë, linjë, poligon. Abstrakt – kur elementi nuk është element real në terren, por konsiderohet vetëm si dukuri.
Shumëllojshmëria	Lloji dhe numri i vlerave që mund të marrë atributi: 0..* - mund të marrë shumë lloje vlerash ose asnjë vlerë 1..* - mund të marrë minimumi 1 vlerë ose shumë vlera 0..1 - mund të mos marrë asnjë vlerë ose nëse merr vlerë, duhet të marrë vetëm 1 vlerë të vetme. 1 – duhet të marrë detyrimisht 1 vlerë
I detyrueshëm	Po – nëse atributi është i detyrueshëm të plotësohet Jo – nëse atributi nuk është i detyrueshëm të plotësohet
Rol-shoqërimi	Në tabelën e lidhjeve “Rol-shoqërimi” tregohen marrëdhëniet hierarkike ndërmjet elementeve të ndryshme në këtë temë, si dhe në temat e tjera. Këto marrëdhënie pasqyrojnë lidhjet që realizohen në skemat UML.

Tabela 2

ATRIBUTET
-- Emri -- Emërtimi i atributit
-- Përkufizimi -- Përkufizimi i elementeve
-- Përshkrimi -- Shënime dhe përshkrime të tjera për elementin [I detyrueshëm: Detyrueshmëria nëse atributi duhet të marrë vlerë, p.sh.: PO]



Tabela 3

ATRIBUTET
♣ Vlera e parë e listës së gatshme, p.sh.: Ligjor -- Emri -- Emërtimi i vlerës -- Përkufizimi -- Përkufizimi i elementeve.
♣ Vlera e dytë (etj.) e listës së gatshme, p.sh.: Joligjor -- Emri -- Emërtimi i vlerës -- Përkufizimi -- Përkufizimi i elementeve.

2.2.3. KARAKTERISTIKAT <<VOIDABLE>> DHE SHUMËLLOJSHMËRIA

Stereotipi <<voidable>> përdoret për të përshkruar ato karakteristika të objekteve gjeohapësinore që mund të jenë ose mund të mos jenë të pranishme në grupet e të dhënave gjeohapësinore edhe pse mund të ekzistojnë në botën reale. Kjo nuk do të thotë që këtyre përkatësive duhet t'u jepet një vlerë.

Për të gjitha karakteristikat, e përcaktuara për objektet gjeohapësinore, duhet të paraqitet një vlerë – ose vlera përkatëse (nëse është e disponueshme në grupin e të dhënave që mirëmbahet nga ofruesi i të dhënave), ose vlera “void”. Një vlerë “void” nënkupton që nuk ekziston një vlerë përkatëse, në grupet e të dhënave gjeohapësinore, që mirëmbahen nga ofruesi i të dhënave ose që asnjë vlerë përkatëse nuk mund të nxirret nga vlerat ekzistuese.

Arsyeja e përdorimit të vlerës “void” duhet të paraqitet kurdo që të jetë e mundur, duke përdorur një nga vlerat e listuara në kodlistën *VleraEArzyesSëPavlefshmërisë* (VoidReasonValue), e cila përmban:

- **E panjohur** (Unknown)

-- Përkufizimi --

Vlera korrekte për këtë element gjeohapësinor nuk njihet ose është e pamatshme nga krijuesi i të dhënave.

-- Përshkrim --

Shembull. Kur “kuota e sipërfaqes së një trupi ujor nga niveli i detit” e një ligeni të caktuar, nuk është matur, atëherë arsyeja e pavlefshmërisë së kësaj karakteristike mund të jetë “E panjohur”.

- **E papopulluar** (Unpopulated)

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë nuk është pjesë e databazës së mirëmbajtur nga krijuesi i të dhënave. Pavarësisht kësaj kjo e dhënë mund të ekzistojë.

-- Përshkrimi --

Shembull. Kur “kuota e sipërfaqes së një trupi ujor nga niveli i detit” nuk është e përfshirë në grupin e të dhënave që përmban objektin gjeohapësinor të liqenit, atëherë vlera e kësaj karakteristike mund të jetë “E papopulluar”

- **Konfidenciale** (Withheld)

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë mund të ekzistojë, por është konfidenciale.

-- Përshkrimi --

Shembull. Të dhënat personale të popullsisë, të cilat ekzistojnë, por që nuk mund të shfaqen, pasi mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Stereotipi <<voidable>> nuk jep asnjë informacion nëse ekziston një karakteristikë në botën reale. Kjo shprehet duke përdorur shumëllojshmërinë:

Nëse një karakteristikë mund të ekzistojë apo mund të mos ekzistojë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 0. P.sh., nëse një adresë ka apo nuk ka një numër shtëpie, shumëllojshmëria përkatëse do të jetë 0..1.

Nëse për një karakteristikë të caktuar ekziston të paktën një vlerë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 1. P.sh., nëse një njësi administrative ka gjithmonë të paktën një emër, shumëllojshmëria përkatëse do të jetë 1..*.

2.2.4. MBULIMET – COVERAGES

Funksionet e mbulimit “Coverages” përdoren për të përshkruar karakteristikat e një fenomeni të botës reale që zhvillohet në kohë dhe, ose hapësirë. Shembuj tipikë të tyre janë temperaturat, lartësitë,

imazheritë etj. Një mbulim përmban një grup vlerash, të cilat shoqërohen me një element gjeohapësinor, kohor, kohor-gjeohapësinor. Domeinet tipike gjeohapësinore janë grupe pikash (p.sh. vendndodhja e sensorëve), kurbat përcaktuese (p.sh. izolinjat), rrjetet (p.sh. ortoimazheria, modelet e lartësive) etj.

Në skemat e aplikimit INSPIRE, funksionet e mbulimit janë përcaktuar si veti të llojeve të objekteve gjeohapësinore, ku lloji i vlerës së kësaj karakteristike është realizim i një prej llojeve të specifikuar në SSH EN ISO 19123-1 dhe SH EN ISO – 3.

Për të përmirësuar përputhjen me standardet e mbulimit në nivelin e zbatimit (p.sh., SSH EN ISO 19136-1 dhe OGC Shërbimi i Mbulimit në Internet) dhe për të përmirësuar harmonizimin ndërtematik, për përdorimin e mbulimeve në INSPIRE, një skemë e aplikimit për llojet e mbulimit është

përfshirë në Modelin Konceptual të Përgjithshëm “Generic Conceptual Model”.

Kjo skemë aplikimi përmban llojet e mëposhtme të mbulimit:

- *RrjetiIMbulimitIKorrigjuar (rektifikuar)*: Mbulimi, domeini i të cilit përbëhet nga një rrjet i korrigjuar, një rrjet për të cilin ka një transformim përfundimtar midis koordinatave të rrjetit dhe koordinatave të sistemit koordinativ referencë (shih figurën 2, majtas).

- *RrjetiIMbulimitReferencë*: Mbulimi, domeini i të cilit përbëhet nga një rrjet referimi, një rrjet i lidhur me një transformim që mund të përdoret për të kthyer vlerat e koordinatave të rrjetit në vlerat e koordinatave të referuara në një sistem referimi koordinativ (shih figurën 1, djathtas).

Aty ku është e mundur përdoren vetëm këto lloje mbulimi (ose një nëntip i tyre) në skemat e aplikimit në INSPIRE.




Figura 1: Shembuj të një rrjeti të korrigjuar (majtas) dhe një rrjeti referues (djathtas)

2.2.5. NUMËRTIMET DHE KODLISTAT (ENUMERATION AND CODE LIST)

Kodlistat modelohen si klasa në skemat e aplikimit, por vlerat e tyre menaxhohen jashtë skemave të aplikimit. Në kodlistën, “vlera të tjera” përcaktohet lloji i përmbajtjes së kodlistës, e përcaktuar specifikisht, si më poshtë:

- **“jo”** përfaqëson kodlistë që përmbajnë vetëm vlera të specifikuara në këtë dokument;

- **“të kufizuara”** përfaqëson kodlistë që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë dokument dhe vlera të tjera të limituara të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave;

- **“të hapura”** përfaqëson kodlistë që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë dokument dhe vlera shtesë në çdo nivel, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave;

- **“po”** përfaqëson kodlistë që përmbajnë vlera të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

Vlerat shtesë të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave nuk duhet të zëvendësojnë, apo të modifikojnë, vlerat ekzistuese, të përcaktuara në dokument.

Në rastin kur ofruesit e të dhënave do të përdorin kodlistë me vlera **“jo”**, pra të specifikuara në dokument, ofruesit janë të detyruar t’i bëjnë këto vlera bashkë me përkufizimet e tyre, të disponueshme në një regjistër. Kjo do të mundësojë që edhe përdoruesit e tjerë t’i kuptojnë këto vlera dhe të kenë mundësi t’i përdorin.

2.2.6. PARAQITJA E DIMENSIONIT KOHOR

Skemat e aplikimit përdorin atributin **“FillimiICiklitJetësor”** dhe **“PërfundimiICiklitJetësor”** për

të regjistruar jetëgjatësinë e një objekti gjeohapësinor.

Atributi “*FillimiCiklitJetësor*” specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Atributi “*PërfundimiCiklitJetësor*” specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në botën reale.

Ndryshimet që bëhen në atributin “*PërfundimiCiklitJetësor*” nuk shkaktojnë ndryshime në atributin “*FillimiCiklitJetësor*”.

- Shënim i rëndësishëm

Disa terma në Katalogun e Tipologjive, si p.sh.: FeatureType, DataType, Void, Coverages etj., nuk janë përkthyer qëllimisht në gjuhën shqipe. Qëllimi parësor është që të mos humbasin kuptimin gjatë përkthimit dhe së dyti të përdoret një gjuhë unike, sipas termave të direktivës INSPIRE.

2.3. DETYRIMET LIGJORE

Në bazë të nenit 16, të ligjit nr. 72/2012, “*Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë*”, ASIG-u është institucioni përgjegjës për krijimin e standardeve, për secilën nga temat e përcaktuara në nenin 11, të këtij ligji, në përputhje me standardet evropiane (direktiva INSPIRE).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinore, për krijimin e NSDI-së në Shqipëri, janë përshtatur nga specifikimet teknike të temave përkatëse në direktivën INSPIRE, si dhe praktikave më të mira ndërkombëtare që mbështesin dhe bazohen në këtë

direktivë. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të zbatojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore.

Standardet (Rregullat e implementimit – IR) duhet të krijohen për fushat e mëposhtme:

- **Metadata** – në këtë fushë direktiva përcakton standardet se si duhen të jenë metadat. Ky standard është unik dhe i aplikueshëm për të gjitha institucionet ose palët e treta (sikurse është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilët do të implementojnë atë (VKM nr. 1077, datë 23.12.2015).

- **Specifikimi i të dhënave** – standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme që do të publikohen. INSPIRE ka përcaktuar disa attribute bazë, të cilat do të shërbejnë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose të nevojave të brendshme, mund të shtojnë attribute të tjera për t'i bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjitha të dhënat që do të shtohen duhet të jenë të dokumentuara dhe të miratuara nga institucionet përgjegjëse lokale.

2.4. FUSHA E VEPRIMIT

Të gjitha autoritetet publike, kompanitë private apo individë që mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinore për llogari të institucioneve publike, janë të detyruara t'i nënshtrohen këtij standardi.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga direktiva INSPIRE ka proceset dhe ciklin jetësor, si më poshtë:




Figura 2: Proceset e ciklit jetësor



“Planifikimi” është procesi gjatë të cilit krijohen strukturat e të dhënave të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënave.

“Vlerësimi” është procesi gjatë të cilit të dhënat ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do të jetë certifikimi i të dhënave ose nevoja për të modifikuar të dhënat që të përshtaten me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit.

“Procesimi (përpunimi)” është procesi gjatë të cilit mbledhen dhe modifikohen atributet e të dhënave për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuara gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi janë bashkësi të dhënash gati për t’u publikuar.

“Shpërndarja” është procesi gjatë të cilit të dhënat vihen në dispozicion për përdoruesit (qytetarët, autoritetet publike, organizatat ose palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, të përdorë, të analizojë ose të citojë të dhënat. Publikimi i të dhënave bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit.

“Zbulimi” është proces i vazhdueshëm gjatë të cilit zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jociësore në të dhënat e publikuara.

“Analiza” është procesi i analizimit të të dhënave të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë këtij procesi merret vendimi çfarë do të bëhet me të dhënat që janë evidentuar.

“Përditësimi” është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënave. Ky proces regjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënave ekzistuese dhe të publikuara.

“Arkivimi” është procesi gjatë të cilit bashkësitë e të dhënave që nuk nevojiten të aksesohen arkivohen, duke u bazuar në standarde kombëtare dhe në legjislacionin në fuqi të vendit ku implementohet standardi. Rezultat i këtij procesi janë të dhënat që bëhen të pa aksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen, për

arsye të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose me standardet specifike.

“Shkatërrimi” është procesi gjatë të cilit të dhënat bëhen të parikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde kombëtare ose në legjislacione në fuqi.

3. TEMA

3.1. ZONAT EKOLOGJIKE

3.1.1. PARATHËNIE

Tema “Zonat ekologjike” përmban zona të cilat kanë kushte ekologjike relativisht homogjene, me karakteristika të përbashkëta mjedisore dhe ekologjike. Këto zona përcaktohen në bazë të një sërë faktorësh të ndërlidhur, siç janë gjeologjia, toka, klima, gjeomorfologjia dhe vegjetacioni.

Modeli i të dhënave të temës “Zonat ekologjike” siguron një përfaqësim të përbashkët panevropian të këtyre zonave. Objekti gjeohapësinor i “Zonave ekologjike” është objekti kryesor gjeohapësinor i skemës së aplikimit për përfaqësimin e rajoneve ose të zonave me kushte ekologjike relativisht homogjene dhe me karakteristika të përbashkëta. Ky objekt gjeohapësinor do të lejojë përshkrimin e duhur të klasifikimit të zonave ekologjike për çdo veçori që përfaqëson. Skema e aplikimit mbështet klasifikimin e zonave ekologjike sipas përcaktimit të Direktivës Evropiane të Habitaveve, por, gjithashtu, plotëson kërkesat e ngritura nga specifikimet teknike të standardit me temë “Zonat ekologjike”.

Tema “Zonat ekologjike” ka një ndërvarësi me disa nga temat e tjera, si:

- *Zonat e mbrojtura;*
- *Habitatet;*
- *Shpërndarja e specieve.*

Duke qenë se “Zonat ekologjike” bazohen në klasifikimin e bërë nga dokumenti udhëzues i Direktivës së Habitaveve, këto zona janë baza e një sërë seminaresh, të cilat vlerësojnë rrjetin Natura 2000, e cila përdoret për raportim çdo 6 vjet mbi “statusin e ruajtjes” të llojeve të habitateve dhe të specieve të mbrojtura nga direktiva (shiko figurën 3).




Figura 3: Harta në të majtë tregon shpërndarjen e një lloji habitati në Francë me ngjyrë të koduar nga zona ekologjike ku ai ndodhet, harta në të djathtë tregon “statusin e ruajtjes” së të njëjtit habitat sipas zonës ekologjike

Të gjitha zonat ekologjike të Evropës përcaktohen në specifikimin e të dhënave të Direktivës së Habitaveve, e cila ofron një listë të katër zonave. Kjo direktivë përmban 9 rajone, që përfshijnë 27 shtete anëtare të BE-së. Këto rajone janë përshtatur në mënyrë të tillë për t’i bërë ato më të lehta për t’u përdorur në mënyrë administrative dhe formojnë njësi ekologjikisht koherente me kushte të ngjashme mjedisore, të cilat mund të dallohen, duke bërë krahasimin e hartës me klasifikimet e tjera mjedisore të Evropës. Këto rajone ekologjike të detajuara mund të përfshijnë, gjithashtu, nënkategori lokale të zonave ekologjike të përshkruara në Direktivën e Habitaveve.




Figura 4: Harta e rajoneve biogeografike, panevropiane



Duhet të theksohet se ndërsa këto specifikime të dhënash përqendrohen në dimensionin evropian, të njëjtat koncepte dhe udhëzime janë po aq të vlefshme për zonat ekologjike në nivelin e shtetit anëtar. Shtetet anëtare janë në gjendje të ngarkojnë kodlista për zonat ekologjike përmes një regjistri kodlistash. Për më tepër, këto specifikime të dhënash nuk nënkuptojnë që zonat ekologjike evropiane janë një zëvendësim i zonave më të detajuara ekologjike që shtetet anëtare mund të kenë.

3.1.2. TERMA DHE PËRKUFIZIME

- *Neni 17* – neni 17 i Direktivës së Habitaveve kërkon që çdo 6 vjet Shtetet Anëtare të përgatisin raporte që t'i dërgohen Komisionit Evropian për zbatimin e Direktivës. Neni 11 i Direktivës së Habitaveve kërkon që Shtetet Anëtare të monitorojnë habitatet dhe speciet e listuara tek anekset dhe neni 17 kërkon që një raport t'i dërgohet Komisionit Evropian çdo 6 vjet, sipas një formati të dakorduar. Raporti përfshin vlerësime mbi statusin e ruajtjes së llojeve të habitatit dhe llojeve të interesit të komunitetit në nivelin biogeografik.

- *Zonat ekologjike* – zona të cilat kanë kushte ekologjike relativisht homogjene me karakteristika të përbashkëta mjedisore dhe ekologjike.

- *Shtresëzimi mjedisor* – është krijuar për të prodhuar një shtresëzim statistikor të mjedisit evropian, i përshtatshëm për marrjen e mostrave të rastësishme të shtresëzuara të burimeve ekologjike. Në këto shtresa gjenden rajone të gjera ekologjike të përdorura në Direktivën e Habitaveve.

- *Rajonet detare* – janë të përcaktuara në legjislacionin ndërkombëtar, të unionit, kombëtar ose nënkombëtar, me qëllim të vlerësimit, menaxhimit dhe rregullimit.

Shënim. Rajonet detare përdoren në kontekstin e Natura 2000 vetëm për arsye praktike-teknike, ato nuk kanë asnjë status juridik në krahasim me rajonet tokësore ose zonat ekologjike të Direktivës së Habitaveve.

- *Natura 2000* – është një rrjet i gjerë i zonave të mbrojtjes së natyrës në Bashkimin Evropian, i themeluar në bazë të Direktivës së Habitaveve të vitit 1992. Qëllimi i rrjetit është të sigurojë

mbijetesën afatgjatë të specieve dhe habitateve më me vlerë dhe më të kërcënuara të Evropës. Ai përbëhet nga zonat speciale të konservimit, të përcaktuara nga shtetet anëtare në bazë të Direktivës së Habitaveve, dhe, gjithashtu, përfshin zonat e veçanta të mbrojtjes të përcaktuara nën Direktivën e Zogjve të vitit 1979. Themelimi i këtij rrjeti të zonave të mbrojtura, gjithashtu, përmbush një detyrim të komunitetit sipas Konventës për Diversitetin Biologjik.

- *Bimësia natyrore* – harta e Bimësisë Natyrore të Evropës është përpiluar dhe prodhuar nga një ekip ndërkombëtar i gjeobotanistëve. Është botuar për herë të parë më 1979-n, më pas me një version të dytë u botua më 1987-n nga Këshilli i Evropës.

3.1.3. SKEMAT E APLIKIMIT DHE DIAGRAMI UML PËR TEMËN “ZONAT EKOLOGJIKE”

Skema e aplikimit e temës “*Zonat ekologjike*” paraqet një përfaqësim të përbashkët panevropian të zonave ekologjike dhe llojeve të tjera të shtresëzimeve mjedisore dhe rajoneve ekologjike. Tipologjia (feature-i) *ZonatEkologjike* është objekti gjeohapësinor kryesor i kësaj skeme aplikimi për përfaqësimin e rajoneve ose të zonave me kushte ekologjike relativisht homogjene me karakteristika të përbashkëta. Ky lloj objekti gjeohapësinor do të ofrojë një përshkrim të duhur të klasifikimit ekologjik që është përdorur për të identifikuar dhe klasifikuar zonat ekologjike për çdo veçori që përfaqëson. Në këtë aspekt duhet të theksohet se skema e aplikimit jo vetëm që mbështet klasifikimin e zonave ekologjike, siç përcaktohet nga Direktiva Evropiane e Habitaveve, por, gjithashtu, plotëson kërkesat e ngritura nga specifikimet teknike të standardit me temë “Zonat ekologjike”.

Në këtë skemë aplikimi përfshihen katër skema të dallueshme të klasifikimit evropian, megjithatë përmes mekanizmit të kodlistave modeli mund të zgjerohet për të përcaktuar dhe për të përfshirë klasifikime të tjera. Struktura që përmban kjo skemë aplikimi është e thjeshtë, në mënyrë që të realizohet një harmonizim maksimal i të dhënave, si dhe për objektet gjeohapësinore që përfshijnë informacione gjeometrike.




Figura 5: Diagrami UML: Përmbajtja e skemës së aplikimit për temën “Zonat ekologjike”

Në figurën e mësipërme paraqitet përmbledhja e paketës *ZonatEkologjike*, ky objekt gjeohapësinor i referohet paketës bazë *LlojiBazë* të modelit konceptual të përgjithshëm.

Skema e plotë e aplikimit për temën “Zonat ekologjike” është treguar në figurën 6 dhe përshkruhet me detaje, si më poshtë.




Figura 6: Diagrami UML: Përmbajtja e skemës së aplikimit për temën “Zonat ekologjike”



Zonat Ekologjike është i vetmi objekt gjeohapësinor i përfshirë në skemën e aplikimit dhe përfaqëson çdo lloj zone ekologjike. Meqenëse tipologjia (Fetaure Type) *Zonat Ekologjike* mund të përbëhen nga poligone ose poligone shumëpjesësh, përfaqësimi i tyre gjeometrik shprehet me llojin, sipërfaqe e shumëfishhtë. *Zonat ekologjike* përshkruhen nga një klasifikim ekologjik. Sistemi i klasifikimit specifikohet nga tre attribute: informacioni mbi skemën e klasifikimit dhe vlera e klasifikimit që është e zbatueshme për rastin ku sigurohen dy attribute të detyrueshme përkatësisht të quajtura *Skema EKlasifikimit Rajonal* dhe *Klasifikimi Rajonal*. Vlerat për këto attribute mund të zgjidhen nga një kodlistë. Atributi i tretë *Niveli Klasifikimit Rajonal*, i cili është jo i detyrueshëm (*Voidable*) është përcaktuar për të dokumentuar nivelin e sistemit të klasifikimit. Vlerat e mundshme për këtë nivel janë: ndërkombëtar, kombëtar, rajonal ose lokal. Shumë sisteme të ndryshme klasifikimi ekzistojnë në nivele të ndryshme; skema aktuale e aplikimit përfshin vetëm informacione mbi skemën e klasifikimit dhe vlerat përkatëse të 4 sistemeve evropiane të klasifikimit, por skema mund të zgjatet për të përfshirë sisteme të tjera të klasifikimit përmes mekanizmit të kodlistave.

- Natura 2000 dhe Zonat ekologjike

Natura 2000 dhe Zonat ekologjike, siç përshkruhen përkatësisht te Direktiva e Habitaveve

dhe Konventa e Bernës janë njësi raportuese që mbështesin procesin e ruajtjes së natyrës, dhe më konkretisht ruajtjen e specieve dhe llojeve të habitatit, në kushte të ngjashme natyrore në një grup vendesh, pavarësisht kufijve politikë dhe administrativë. Këto zona ekologjike janë tokësore për të krijuar një njësi të ngjashme që mund të përdoret për vlerësimin e 5 rajoneve detare shtesë, bazuar në konventat detare evropiane. Për dallim të zonave ekologjike tokësore, këto rajone detare nuk kanë një bazë ligjore. Do të ketë vetëm një grup të dhënash koresponduese për rajonet Natura 2000 dhe Emerald, të cilat do të sigurohen nga Agjencia Evropiane e Mjedisit.

- Shtresëzimi mjedisor në Evropë.

Zonat Mjedisore të Evropës rrjedhin nga “Shtresëzimi mjedisor” i Evropës. Shtresëzimi bazohet në të dhënat e klimës, të dhënat mbi ndikimin e oqeanit dhe pozicionin gjeografik.

- Bimësia natyrore e Evropës

Kodet për bimësinë natyrore në Evropë rrjedhin nga harta e “Vegjetacionit natyror” të Evropës.

- Rajonet e direktivës në kuadër të Strategjisë Detare

Kodet për rajonet e direktivës së “Strategjisë detare” rrjedhin nga vetë kjo direktivë.

«codeList»	
Direktiva EKornizës	UjoreVlera EKlasifikimitTë Ekoregjioneve
+	Alpe
+	Rajoni Iberiko-Makaronezian
+	Pirenejtë
+	Italia Korsika Malta
+	Dinartet e Ballkanit Perëndimor
+	Ballkani Perëndimor Helenik
+	Ballkani Lindor
+	Malësitë Perëndimore
+	Malësitë Qendrore
+	Karpatet
+	Ullësira Hungareze
+	Provinca Pontiac
+	Rrafshnalta Perëndimore
+	Rrafshnalta Qendrore
+	Krahina Baltike
+	Rrafshnalta Lindore
+	Irlanda dhe Irlanda e Veriut
+	Britania e Madhe
+	Islandë
+	Borealis
+	Tundra
+	Mburoja Skandinave
+	Tajga
+	Kaukaz
+	Depresioni Kaspian

Figura 7: Diagrami për Zonat ekologjike: Kodlista:
Vlerat EKlasifikimitTë DirektivësTë KornizësSë Strategjisë Detare




Figura 8: Diagrami për Zonat ekologjike: Kodlistat




Figura 9: Diagrami për zonat ekologjike




Figura 10: Struktura e diagramit për zonat ekologjike



3.1.4. KATALOGU I TIPOLOGJIVE

3.1.4.1. ZONAT EKOLOGJIKE

-- Emri --

Zonat ekologjike

-- Përkufizimi --

Zona të cilat kanë kushte ekologjike relativisht homogjene me karakteristika të përbashkëta mjedisore dhe ekologjike.

-- Përshkrimi --

Shembull. Evropa është e ndarë në njëmbëdhjetë zona tokësore ekologjike të gjera dhe pesë zona ekologjike detare.

Shënim. Rajonet detare përdoren në kontekstin e Natura 2000 vetëm për arsye praktike dhe teknike, ato nuk kanë asnjë status juridik në kontrast me zonat ekologjike “tokësore”.

-- Tipi i elementit --*FeatureType***ATRIBUTET**

InspireId : Identifikues

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Inspire Id

-- Përkufizimi --

Identifikimi i objektit të jashtëm gjeohapësinor.

-- Përshkrimi --

Një identifikues i jashtëm është një objekt identifikues unik i publikuar nga organi përgjegjës, i cili mund të përdoret nga aplikimet e jashtme për të referuar objektin gjeohapësinor. Identifikuesi është një objekt gjeohapësinor, jo një identifikues i fenomenit në realitet.

[I detyrueshëm: PO]

Gjeometria : MultiSurface

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Gjeometria

-- Përkufizimi --

Gjeometria që përcakton zonën ekologjike.

[I detyrueshëm: PO]

KlasifikimiIZonës : VleratEKlasifikimitTëZonave

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Klasifikimi i zonës

-- Përkufizimi --

Kodi i klasifikimit të zonës, sipas një skeme klasifikimi.

[I detyrueshëm: PO]

SkemaEKlasifikimitTëZonës : VleratESkemësSëKlasifikimitTëZonës

Shumëllojshmëria: [1]



ATRIBUTET

-- Emri --

Skema e klasifikimit të zonës

-- Përkufizimi --

Skema e klasifikimit që përdoret për klasifikimin e rajoneve.

[I detyrueshëm: PO]

◆ NiveliIKlasifikimitTëZonës : VleratENivelitTëKlasifikimitTëZonës

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Niveli i klasifikimit të zonës

-- Përkufizimi --

Niveli i klasifikimit të klasës së rajonit.

[I detyrueshëm: PO]

◆ FillimiICiklitJetësor : Datë-Orë

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Fillimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --

Data dhe ora në të cilën ky version i objekut gjeohapësinor është futur ose ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore.

[I detyrueshëm: PO]

◆ PërfundimiICiklitJetësor : Datë-Orë

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Përfundimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --

Data dhe ora në të cilën ky version i objekut gjeohapësinor u zëvendësua ose u tërhoq nga grupi i të dhënave gjeohapësinore.

[I detyrueshëm: PO]

3.1.4.2. VLERAT E KLASIFIKIMIT TË BIMËSISË NATYRORE

-- Emri --

Vlerat e klasifikimit të bimësisë natyrore

-- Përkufizimi --

Kodet për klasifikimin e bimësisë natyrore.

-- Tipi i elementit --

Kodlistë

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME

← Gjeneruar nga «codeList» VleratEKlasifikimitTëBimësisëNatyrore tek «codeList» VleratEKlasifikimitTëZonave

ATRIBUTET

◆ TundratArktikeDheBimësiaAlpine

-- Emri --

Tundrat arktike dhe bimësia alpine.

-- Përkufizimi --

Tundrat arktike dhe bimësia alpine.



ATRIBUTET

ShkurreTëVoglaNëAtlantikë

Emri --

Shkurre të vogla në Atlantikë

Përkufizimi --

Shkurret të vogla në Atlantikë.

BimësiaBregdetareDheBimësiaHalofitikeNëBrendësi

Emri --

Bimësia bregdetare dhe bimësia halofitike në brendësi

Përkufizimi --

Bimësia bregdetare dhe bimësia halofitike në brendësi

Shkretëtirë

Emri --

Shkretëtirë

Përkufizimi --

Shkretëtirë.

VegjetacioniIGrykëderdhjeveTëLumenjveDheTreguesveTëUjëraveTëËmbëlDheTokaveMeLagështi

Emri --

Vegjetacioni i grykëderdhjeve të lumenjve dhe treguesve të ujërave të ëmbla dhe tokave me lagështi

Përkufizimi --

Bimësia e fushave me lagështi.

HapësiraPyjoreLivadheStepaAlternuarMeGjethetëGjeraDheKullotaTëThataDukeAlternuarMeShkurreXerofitik

Emri --

Stepat pyjore dhe kullotat e thata që alternohen me shkurre

Përkufizimi --

Stepat pyjore (stepat e livadhit që alternohen me pyje gjethë gjera) dhe kullota të thata që alternohen me shkurre xerofitike.

PyjeGjethëGjeraTëPërzieraMeHigro-Termofile

Emri --

Pyje gjethë gjera të përziera me higro-termofile

Përkufizimi --

Pyje gjethë gjera të përziera me higro-termofile.

ShkurreDhePyjeSklerofileMesdhetare

Emri --

Shkurre dhe pyje sklerofile mesdhetare

Përkufizimi --

Shkurre dhe pyje sklerofile mesdhetare.

MesofiteDheHigromesofiteTëPërzieraMePyjeHalorGjethëGjera

Emri --

Mesofite dhe higromesofite të përziera me pyje halor gjethë gjera

Përkufizimi --

Mesofite dhe higrofitite të përziera me pyje halor gjethë gjera.


ATRIBUTET

PyjeMeGjetheHaloreMezofiteDheGjetheGjeraTëPërziera

-- Emri --

Pyje të përziera me gjethe halore mezofite dhe gjethe gjera

-- Përkufizimi --

Pyje të përziera me gjethe halore mezofite dhe gjethe gjera.

Moçal

-- Emri --

Moçal

-- Përkufizimi --

Moçal.

VegjetacioniIXeherorëve

-- Emri --

Vegjetacioni i xeherorëve

-- Përkufizimi --

Vegjetacioni i xeherorëve.

ShkretëtiratPolareDheVegjetacioniNivalionalIMaleveTëLarta

-- Emri --

Shkretëtirat polare dhe vegjetacioni aluvional i maleve të larta

-- Përkufizimi --

Shkretëtirat polare dhe vegjetacioni aluvional i maleve të larta.

BimësiaEKallamishteveTëLartaKënetatEGjelbërtaDheBimësiaUjore

-- Emri --

Bimësia e kallamishteve të larta, kënetave të gjelbra dhe bimësia ujore

-- Përkufizimi --

Bimësia e kallamishteve të larta, kënetave të gjelbra dhe bimësia ujore.

Stepat

-- Emri --

Stepat

-- Përkufizimi --

Stepat.

BimëPyjoreSubarktikeBorealeDheNemoraleMontaneSiDheBimësiSubalpineDheMesdhetare.

-- Emri --

Bimë pyjore subarktike boreale dhe nemorale montane, si dhe bimësi subalpine dhe mesdhetare

-- Përkufizimi --

Bimë pyjore subarktike, boreale dhe nemorale-montane, si dhe bimësi subalpine dhe mesdhetare.

PyjetMoçalisteDheKënetore

-- Emri --

Pyjet moçalore dhe kënetore

-- Përkufizimi --

Pyjet moçalore dhe kënetore.



ATRIBUTET

PyjeGjetheGjerëTëPërzierMeTermofile

-- Emri --

Pyje gjethe gjerë të përzier me termofile

-- Përkufizimi --

Pyje gjethe gjerë të përzier me termofile.

PyjeHaloreXerofitikePyjeTëDendurDheShkurre

-- Emri --

Pyje halore xerofitike, pyje të dendur dhe shkurre

-- Përkufizimi --

Pyje halore xerofitike, pyje të dendur dhe shkurre.

3.1.4.3. VLERAT E KLASIFIKIMIT TË DIREKTIVËS SË KORNIZËS SË STRATEGJISË DETARE

-- Emri --

Vlerat e klasifikimit të Direktivës së Kornizës së Strategjisë Detare.

-- Përkufizimi --

Kodet për klasifikimin e Direktivës së Kornizës së Strategjisë Detare.

-- Tipi i elementit --

Kodlistë

LIDHJE STRUKTURE TË JASHTME

Gjeneruar nga «codeList» VleratEKlasifikimitTëDirektivaveTëKornizësSëStrategjisëDetare tek «codeList»

VleratEKlasifikimitTëZonave

ATRIBUTET

DetiBaltik

-- Emri --

Deti Baltik

-- Përkufizimi --

Rol-shoqërimi	Në tabelën e lidhjeve “Rol-shoqërimi” tregohen marrëdhëniet hierarkike ndërmjet elementeve të ndryshme në këtë temë, si dhe në temat e tjera. Këto marrëdhënie pasqyrojnë lidhjet që realizohen në skemat UML.

Tabela 2

ATRIBUTET
-- Emri -- Emërtimi i atributit
-- Përkufizimi -- Përkufizimi i elementeve.
-- Përshkrimi -- Shënime dhe përshkrime të tjera për elementin. [I detyrueshëm: Detyrueshmëria nëse atributi duhet të marrë vlerë, p.sh: PO]

Tabela 3

ATRIBUTET
Vlera e parë e listës së gatshme, p.sh: Ligjor -- Emri -- Emërtimi i vlerës -- Përkufizimi -- Përkufizimi i elementeve.
Vlera e dytë e listës së gatshme, p.sh: Joligjor -- Emri -- Emërtimi i vlerës. -- Përkufizimi -- Përkufizimi i elementeve.

2.2.3 Karakteristikat <<voidable>> dhe shumëllojshmëria

Stereotipi <<voidable>> përdoret për të përshkruar ato karakteristika të objekteve gjeohapësinore që mund të jenë ose mund të mos jenë të pranishme në grupet e të dhënave gjeohapësinore edhe pse mund të ekzistojnë në realitet. Kjo nuk do të thotë që këtyre përkatësive duhet t'u jepet një vlerë.

Për të gjitha karakteristikat, e përcaktuara për objektet gjeohapësinore, duhet të paraqitet një vlerë ose vlera përkatëse (nëse është e disponueshme në grupin e të dhënave që mirëmbahet nga ofruesi i të dhënave), ose vlera 'void'. Një vlerë 'void' nënkupton

që nuk ekziston një vlerë përkatëse, në grupet e të dhënave gjeohapësinore, që mirëmbahen nga ofruesi i të dhënave ose që asnjë vlerë përkatëse nuk mund të nxirret nga vlerat ekzistuese.

Arsyeja e përdorimit të vlerës 'void' duhet të paraqitet kurdo që të jetë e mundur, duke përdorur një nga vlerat e listuara në kodlistën *VleraEArzyesSëPavlefshmërisë* (*VoidReasonValue*), e cila përmban:

- **E panjohur (unknown)**

-- **Përkufizimi** --

Vlera korrekte për këtë element gjeohapësinor nuk njihet ose është e pamatshme nga krijuesi i të dhënave.

-- Përshkrim --

Shembull. Kur “kuota e sipërfaqes së një trupi ujon nga niveli i detit” e një liqeni të caktuar, nuk është matur, atëherë arsyeja e pavlefshmërisë së kësaj karakteristike mund të jetë “E panjohur”.

- E papopulluar (Unpopulated)**-- Përkufizimi --**

Kjo karakteristikë nuk është pjesë e databazës së mirëmbajtur nga krijuesi i të dhënave. Pavarësisht kësaj kjo e dhënë mund të ekzistojë.

-- Përshkrimi --

Shembull. Kur “kuota e sipërfaqes së një trupi ujon nga niveli i detit” nuk është e përfshirë në grupin e të dhënave që përmban objektin gjeohapësinor të liqenit, atëherë vlera e kësaj karakteristike mund të jetë “E pa populluar”.

- Konfidenciale (Withheld)**-- Përkufizimi --**

Kjo karakteristikë mund të ekzistojë por është konfidenciale.

--Përshkrimi --

Shembull. Të dhënat personale të popullatës, të cilat ekzistojnë, por që nuk mund të shfaqen pasi mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Stereotipi <<voidable>> nuk jep asnjë informacion nëse ekziston një karakteristikë në realitet. Kjo shprehet duke përdorur shumëllojshmërinë:

Nëse një karakteristikë mund të ekzistojë apo mund të mos ekzistojë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 0. P.sh. nëse një adresë ka apo nuk ka një numër shtëpie, shumëllojshmëria përkatëse do të jetë 0..1.

Nëse për një karakteristikë të caktuar ekziston të paktën një vlerë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 1. P.sh. nëse një njësi administrative ka gjithmonë të paktën një emër, shumëllojshmëria përkatëse do të jetë 1..*.

2.2.4 Mbulimet - Coverages

Funksionet e mbulimit “Coverages” përdoren për të përshkruar karakteristikat e një fenomeni të botës




Figura 1 - Shembuj të një rrjeti të korrigjuar (majtas) dhe një rrjeti referues (djathtas)

reale që zhvillohet në kohë dhe/ose hapësirë. Shembuj tipikë të tyre janë temperaturat, lartësitë, imazheritë etj. Një mbulim përmban një grup vlerash, të cilat shoqërohen me një element gjeohapësinor, kohor, kohor-gjeohapësinor. *Domein*-et tipike gjeohapësinore janë grupe pikash (p.sh. vendndodhja e sensorëve), kurbat përcaktuese (p.sh. izolinjat), rrjetet (p.sh.: ortoimazheria, modelet e lartësive) etj.

Në skemat e aplikimit të INSPIRE, funksionet e mbulimit janë përcaktuar si veti të llojeve të objekteve gjeohapësinore, ku lloji i vlerës së kësaj karakteristike është realizim i një prej llojeve të specifikuar në SSH EN ISO 19123-1 dhe SH EN ISO-3.


Për të përmirësuar përputhjen me standardet e mbulimit në nivelin e zbatimit (p.sh. SSH EN ISO 19136-1 dhe OGC Shërbimi i Mbulimit në Internet) dhe për të përmirësuar harmonizimin ndër tematik, për përdorimin e mbulimeve në INSPIRE, një skemë e aplikimit për llojet e mbulimit është përfshirë në “Modelin konceptual të përgjithshëm” (*Generic Conceptual Model*).

Kjo skemë aplikimi përmban llojet e mëposhtme të mbulimit:

- *RrjetiIMbulimitIKorrigjuar (rekthifikuar)*: Mbulimi, *domein*-i i të cilit përbëhet nga një rrjet i korrigjuar, një rrjet për të cilin ka një transformim përfundimtar midis koordinatave të rrjetit dhe koordinatave të sistemit koordinativ referencë (shih figurën 1, majtas).

- *RrjetiIMbulimitReferencë*: Mbulimi, *domein*-i i të cilit përbëhet nga një rrjet referimi, një rrjet i lidhur me një transformim që mund të përdoret për të kthyer vlerat e koordinatave të rrjetit në vlerat e koordinatave të referuara në një sistem referimi koordinativ (shih figurën 1, djathtas).

Aty ku është e mundur përdoren vetëm këto lloje mbulimi (ose një nëntip i tyre) në skemat e aplikimit në INSPIRE.





2.2.5 Numërtimet dhe kodlistat (Enumeration and code list)

Kodlistat modelohen si klasa në skemat e aplikimit, por vlerat e tyre menaxhohen jashtë skemave të aplikimit. Në kodlistën, 'vlera të tjera' përcaktohet lloji i përmbajtjes së kodlistës, e përcaktuar specifikisht si më poshtë:

- '**jo**' përfaqëson kodlista që përmbajnë vetëm vlera të specifikuar në këtë dokument;
- '**të kufizuara**' përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të specifikuar në këtë dokument dhe vlera të tjera të limituara, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave;
- '**të hapura**' përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të specifikuar në këtë dokument dhe vlera shtesë në çdo nivel, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave;
- '**po**' përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

Vlerat shtesë, të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave, nuk duhet të zëvendësojnë, apo të modifikojnë vlerat ekzistuese, të përcaktuara në dokument.

Në rastin kur ofruesit e të dhënave do të përdorin kodlista me vlera '**jo**', pra të specifikuar në dokument, ofruesit janë të detyruar t'i bëjnë këto vlera bashkë me përkufizimet e tyre, të disponueshme në një regjistrë. Kjo do të mundësojë që edhe përdoruesit e tjerë t'i kuptojnë këto vlera dhe të kenë mundësi t'i përdorin.

2.2.6 Paraqitja e dimensionit kohor

Skemat e aplikimit përdorin atributin "*FillimiICiklitJetësor*" dhe "*PërfundimiICiklitJetësor*" për të regjistruar jetëgjatësinë e një objekti gjeohapësinor.

Atributi "*FillimiICiklitJetësor*" specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Atributi "*PërfundimiICiklitJetësor*" specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në botën reale.

Ndryshimet që bëhen në atributin "*PërfundimiICiklitJetësor*" nuk shkaktojnë ndryshime në atributin "*FillimiICiklitJetësor*".

Shënim i rëndësishëm.

Disa terma në Katalogun e tipologjive, si p.sh.: *FeatureType*, *DataType*, *Void*, *Coverages* etj., nuk janë përkthyer qëllimisht në gjuhën shqipe. Qëllimi

parësor është që të mos humbasin kuptimin gjatë përkthimit dhe së dyti të përdoret një gjuhë unike sipas termave të direktivës INSPIRE.

2.3 Detyrimet ligjore

Në bazë të nenit 16, të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", ASIG-u është institucioni përgjegjës për krijimin e standardeve, për secilën nga temat e përcaktuara në nenin 11, të këtij ligji, në përputhje me standardet evropiane (direktiva INSPIRE).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinore, për krijimin e NSDI-së në Shqipëri, janë përshtatur nga specifikimet teknike të temave përkatëse në direktivën INSPIRE, si dhe nga praktikat më të mira ndërkombëtare që mbështesin dhe bazohen në këtë direktivë. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të zbatojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore.

Standardet (Rregullat e implementimit - IR) duhet të krijohen për fushat e mëposhtme:

- **Metadata** – në këtë fushë direktiva përcakton standardet se si duhen të jenë metadatat. Ky standard është unik dhe i aplikueshëm për të gjitha institucionet ose palët e treta (sikurse është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilat do ta implementojnë atë (VKM-ja nr. 1077, datë 23.12.2015).

- **Specifikimi i të dhënave** – standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme që do të publikohen. INSPIRE ka përcaktuar disa attribute bazë të cilat do të shërbejnë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose të nevojave të brendshme, mund të shtojnë attribute të tjera për t'i bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjitha të dhënat që do të shtohen duhet të jenë të dokumentuara dhe të miratuara nga institucionet përgjegjëse lokale.

2.4 Fusha e veprimit

Të gjitha autoritetet publike, kompanitë private apo individë që mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinore për llogari të institucioneve publike, janë të detyruar t'i nënshtrohen këtij standardi.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga direktiva INSPIRE ka proceset dhe ciklin jetësor, si më poshtë:




Figura 2 - Proceset e ciklit jetësor

Planifikimi – Është procesi gjatë të cilit krijohen strukturat e të dhënave të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënave.

Vlerësimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do të jetë certifikimi i të dhënave ose nevoja për të modifikuar të dhënat që të përshtaten me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit.

Procesimi (përpunimi) – Është procesi gjatë të cilit mbledhen dhe modifikohen atributet e të dhënave për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuara gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi janë bashkësi të dhënash gati për t'u publikuar.

Shpërndarja – Është procesi gjatë të cilit të dhënat vihen në dispozicion për përdoruesit (qytetarët, autoritetet publike, organizatat ose palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, të përdorë, të analizojë ose të citojë të dhënat. Publikimi i të dhënave bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit.

Zbulimi – Është procesi i vazhdueshëm gjatë të cilit zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jociësore në të dhënat e publikuara.

Analiza – Është procesi i analizimit të të dhënave të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë këtij procesi merret vendimi çfarë do të bëhet me të dhënat që janë evidentuar.

Përditësimi – Është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënave. Ky proces regjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënave ekzistuese dhe të publikuara.

Arkivimi – Është procesi gjatë të cilit bashkësitë e të dhënave që nuk nevojiten të aksesohen, arkivohen duke u bazuar në standarde kombëtare dhe në legjislacionin në fuqi të vendit ku implementohet standardi. Rezultati i këtij procesi janë të dhënat që bëhen të pa aksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen, për arsye të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose me standardet specifike.

Shkatërrimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat bëhen të parikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde kombëtare ose në legjislacione në fuqi.

3. TEMA

3.1 Shpërndarja e specieve

3.1.1 Parathënie

Tema “*Shpërndarja e specieve*” përfshin shpërndarjen gjeografike të specieve shtazore dhe bimore të grumbulluara nga një rrjet, një rajon, njësi administrative ose njësi të tjera analitike. Kjo temë i referohet shpërndarjes së një specie të caktuar dhe e paraqet gjendjen si një përfaqësim gjeohapësinor i një specie, në një vendndodhje dhe një periudhë kohore specifike. Në bazë të specifikimit të të dhënave të kësaj teme përcaktohet në qoftë se bëhet fjalë për “specie”, si dhe kur duhet të konsiderohet si një sinonim i termit të saktë shkencor të “taksonit”. Modeli i zgjeruar i kësaj teme ofron mundësinë e lidhjes me vëzhgimet origjinale të përdorura si burime dhe kjo për shkak të disa prej rasteve të përdorimit të autoriteteve lokale ose studiuesve.

Shpërndarja e specieve merret me grumbullimet dhe bashkimin e vëzhgimeve të papërpunuara për të



krijuar shpërndarje më të përgjithshme. Megjithatë, në disa raste dallimi ndërmjet vëzhgimit të papërpunuar dhe atij të grumbulluar mund të jetë i paqartë. Për shembull, nëse shpërndarja paraqet rezultatet e një programi të bazuar në rrjet në një moment të vetëm kohor. Megjithatë standardi duhet të përballojë një organizim të tillë është krijuar për të bërë të mundur përdorimin e tij edhe për vëzhgime të papërpunuara.

Bashkësitë tematike kodojnë të dhënat e “Shpërndarjes së specieve”, si koleksione të tipologjive, d.m.th grupe të veçorive individuale, siç janë poligonet e përfaqësuar në një grup të dhënash, modeli bazohet në njësitë e shpërndarjes dhe koleksionet që ato përmbajnë.

Gjatë kësaj teme janë përdorur disa terma dhe një ndër termat kryesorë është “specie”. Koncepti i një “specie” në thelb është gjykimi i ekspertëve i vendosur mbi natyrën dhe gjykimet njerëzore në këtë fushë. Dy terma të tjerë që janë përdorur në këtë temë dhe përshkruajnë procesin e vëzhgimit janë: termi “të mbledhur”, që më së shpeshti nënkupton “që formohet në një klasë ose grupim” si dhe “i bashkuar”, që do të thotë “kombinohen për të formuar një strukturë”.

Tema “Shpërndarja e specieve” ka një ndërvlerësi me disa nga temat si:

- Zonat e mbrojtura;
- Infrastruktura për monitorimin e mjedisit;
- Zonat ekologjike;
- Habitatet.

Çdo njësi është e specifikuar nga *SkemaEspecieveReferencë* e cila i referohet një zgjedhje të tre listave referente të njohura gjerësisht dhe një *Id-je* nga *IdEspecieveReferencë* që ka të bëjë me listën e referimit për speciet e dhëna me interes. *BE-Nomen* është lista e referencës që do të përdoret. Nëse një takson është i shënuar në *BE-Nomen*, kjo referencë duhet të përdoret si zgjedhja e parë. Nëse nuk është e shënuar në *BE-Nomen*, zgjedhja e dytë është *EUNIS*, nëse jo në *EUNIS*, mund të përdoret *Natura2000*.

Skema lejon shoqërimin e metadatave në secilën njësi përmes tipologjisë *BurimiInformacionit*. Ekzistojnë një mori qasjesh dhe metodologjish për mbledhjen e të dhënave për vëzhgimet e specieve, që në fakt rrjedhin nga shpërndarja e specieve. *BurimiInformacionit* është metadata e nivelit të tipologjive që lejon përshkrimin e informacionit të metodologjisë për secilin shembull specifik të informacionit të shpërndarjes. Këto metadata mund

të ndahen në shpërndarjen e specieve, por kur shkarkohen nga një përdorues ato paraqiten si pjesë e të dhënave *GML*. Skema e zgjeruar gjithashtu jep mundësinë për t'u lidhur me të dhënat e vëzhgimit në specifikimin e objekteve të monitorimit të mjedisit dhe përveç kësaj përfshin një atribut i cili lejon lidhjen me të dhënat origjinale të vëzhgimit që mund të arrihen nga ofruesit e të dhënave *GBIF*.

Burimet e të dhënave dhe procesi i prodhimit të të dhënave

Speciet shpërndahen sipas kërkesave dhe sjelljeve të tyre ekologjike. Shpërndarjet mund të përfaqësohen në një gamë të gjerë të formateve, duke përfshirë njësi administrative ose statistikore, harta të vëzhgimeve të bazuara në rrjet (potencialisht metribute që lidhen me secilin katror të rrjetit), poligone që kanë kufijtë e tyre dhe sipërfaqet e parashikuara. Në to paraqitet përshkrimi i të dhënave, përshkrimi i informacionit të shpërndarjes dhe përshkrimi i informacionit të burimit. Figura e mëposhtme tregon shembuj të tri formateve të fundit.

Vende ose komunitete të ndryshme përdorin metoda të ndryshme për mbledhjen e të dhënave. Metodatat e mbledhjes janë të gjera dhe përfshijnë:

- Vëzhgime të rastësishme të specieve (siç janë të dhënat e ofruara nga vullnetarë apo nga grupe lokale të regjistrimit);
- Koleksione shkencore të specieve;
- Anketime sistematike qoftë gjeografikisht të vazhdueshme ose në rrjete reference;
- Programet e monitorimit të specieve.

Në mënyrë të ngjashme, metodatat e përdorura për të nxjerrë shpërndarjen mund të përfshijnë një larmi teknikash dhe fizikisht të ndryshojnë me kalimin e kohës. Prandaj është e rëndësishme që detajet e metodologjisë së përdorur për të nxjerrë shpërndarjet të përshkruhen qartë dhe në mënyrë adekuate në metadatat shoqëruese. Për më tepër, një shpërndarje e vetme e specieve mund të përfaqësojë bashkimin e një varg burimesh të veçanta dhe duke pasur parasysh që cilësia mund të ndryshojë. Është e rëndësishme që burimet të përshkruhen në mënyrën e duhur dhe të jetë e mundur të përcaktohet se çfarë burimi kontribuoi në shpërndarjen e përgjithshme. Burimet për lëndën e parë dhe ofruesin e të dhënave të grumbulluara/të bashkuara janë attribute kryesore për t'i dhënë përdoruesit të fundit mundësinë për të interpretuar një shpërndarje specifike të specieve.



Figura 3 - Shembuj të llojeve të ndryshme të shpërndarjes së specieve. Vëzhgimet e papërpunuara janë përmbledhur në një rrjet prej 10 km katror dhe me ngjyra sipas vitit të regjistruar

Komiteti i Përbashkët i Mbrojtjes së Natyrës, Anglia dhe Uells.



Figura 4 - Speciet dhe shpërndarja për riprodhim
Burimi: Qendra Norvegjeze e Informacionit për Biodiversitetin

Në këtë pikë duhet të përcaktojmë se kur flasim për “specie” përgjatë të gjithë këtij specifikimi termi i saktë shkencor që përdoret është “takson”. Ai përcakton një grup të organizmave që gjykohen nga një taksonomi, që i përkasin një klase të përcaktuar e cila pasqyron marrëdhëniet filogjenetike. Taksoni përshkruhet në nivele të ndryshme sistematike si nënlojshmëri, specie, gjini ose nivel familjar. Koncepti i një “specie” është thelbësisht, një gjykim i ekspertëve i vendosur mbi natyrën. Si rezultat nuk është as përfundimtar dhe as i caktuar. Megjithatë nomenklatura përcakton një sërë rregullash sesi emrat e vlefshëm duhet t’u caktohen këtyre koncepteve, koncepti i caktuar fillimisht një emër mund të ketë ose do të ndryshojë me kalimin e

kohës. Një ndër objektivat kryesor të shpërndarjes së specieve është krijimi i një fotografie të vetme të konsoliduar në një varg burimesh, ku duhet të merren mendimet dhe ndryshimet e realizuara nga ofruesit e të dhënave për krijimin e një produkti të vetëm.

Ekzistojnë një varg atributesh që mund të shoqërohen me speciet, siç janë statusi juridik zyrtar (direktivat e BE-së, konventat ndërkombëtare, ligji kombëtar), statusi i listës së rivendosur, përgjegjësia kombëtare ose interesa të tjera. Këto attribute mund të jenë thelbësore për aplikime të veçanta, një atribut i tillë konsiderohet përtej specifikimit aktual të të dhënave.



Specifikimi i të dhënave të temës “*Shpërndarja e specieve*”, thekson zgjedhjen e një identifikuesi specifik, një nga tre listat e referencave të njohura gjerësisht nga Bashkimi Evropian. Në këtë specifikim të dhënash përfshihen atributet e shpërndarjes siç janë statusi i rezidencës, madhësia e popullatës brenda njësisë gjeohapësinore, të dhëna të tjera të ndjeshme (kjo është një çështje veçanërisht e rëndësishme për “*Shpërndarjen e specieve*”, pasi disa specie të rralla janë të rrezikuara nga gjuetia e paligjshme, kështu që vendndodhjet e tyre janë veçanërisht të ndjeshme) dhe nëse speciet janë kërkuar në mënyrë aktive. Gjithashtu ruhet emri origjinal i specieve dhe koncepti i caktuar taksonomik i njohur dhe i përdorur nga ofruesi i të dhënave.

Rastet e përdorimit

Qëllimet e përgjithshme, për mbledhjen e të dhënave për speciet dhe modelimin e ndodhjes dhe shpërndarjes së tyre, janë si më poshtë:

- *Kërkimi shkencor*, që është veprimtaria kërkimore-shkencore, që ka për qëllim kryesor zgjerimin, thellimin, rikonceptimin dhe riintegrimin e njohurive shkencore mbi fenomenet e studiuar dhe të kuptuarit teorik të ndërveprimit midis aktorëve të ndryshëm dhe vetë procesit ku ato ndikojnë.

- *Mbrojtja e natyrës* që përfshin:

- Ruajtjen e biodiversiteti, të ekosistemeve e të peizazhit natyror;

- Masat për mbrojtjen e pyjeve: natyrore, pjesërisht natyrore, komplekseve pyjore dhe të tokës pyjore, rrjedhave dhe burimeve ujore, florës dhe faunës në një rajon pyjor;

- Masat për mbrojtjen e stacioneve të gjeneve dhe të farërave të varieteteve vendase të drurëve.

- *Menaxhimi i burimeve*. Përdorimi i instrumenteve ligjore si vlerësimi strategjik mjedisor *VSM* (për politikën, planet dhe programet) dhe vlerësimi i ndikimit mjedisor *VNM* (për projektet), si dhe planifikimi gjeohapësinor në përgjithësi, në nivel rajonal dhe lokal.

- *Bërja e politikave*. Raportimi i shteteve anëtare të BE-së dhe KE-së për “statusin e ruajtjes” së specieve.

3.1.2 Skemat e aplikimit dhe diagrami UML për nëntemën “Shpërndarja e specieve”

Speciet shpërndahen në realitet sipas sjelljeve të tyre ekologjike. Ekzistojnë disa metodologji për mbledhjen e të dhënave mbi vëzhgimet e specieve. Synimi i këtij specifikimi të dhënash është të krijojë një skemë aplikimi të përgjithshme, që mund të përdoret gjerësisht, për të mundësuar shpërndarjen maksimale të të dhënave midis burimeve të ndryshme.

Lloji i objektit gjeohapësinor *GrupiITëDhënavePërShpërndarjenESpecieve* paraqet koleksione të njësive të shpërndarjes së specieve, të përcaktuara nga lloji i objektit gjeohapësinor *NjësiaEShpërndarjesSëSpecieve*.

GrupiITëDhënavePërShpërndarjenESpecieve mund të ketë një shtrirje *domein-i*, një jetëgjatësi për një version dhe emër si attribute të pavlefshme. *NjësiaEShpërndarjesSëSpecieve* do të përdoret për të paraqitur të dhënat e shpërndarjes së specieve të grumbulluara mbi qelizat e rrjetit ose zonat e çdo njësie tjetër analitike me gjeometri (si p.sh. zonat administrative) dhe për periudha kohore kur dukuritë janë regjistruar. Njësitë e shpërndarjes së specieve mbajnë informacione mbi identitetin e specieve që ndodhin rreth ciklit jetësor të objektit të të dhënave. *Datatype-i LlojiInformacioniTëShpërndarjes* siguron informacion në lidhje me kategorinë e ndodhjes ose madhësinë e popullatës, statusin e vendbanimit dhe informacion mbi ndjeshmërinë d.m.th. nëse kombinimi i vendndodhjes dhe specieve në një rast specifik është i ndjeshëm për qëllime të mbrojtjes së natyrës.

Për të zvogëluar problemet e ndërveprimit që lidhen me emërtimin dhe klasifikimin e specieve, *NjësiaEShpërndarjesSëSpecieve* është krijuar për të përdorur një referencë të vazhdueshme për një emër specie të mirëpërcaktuar përmes një *Id-je* që vjen nga listat kryesore, siç janë: *BE-Nomen*, *EUNIS* dhe *Natura2000*.




Figura 5 - Diagrami e paketës UML, skema e aplikimit të temës “Shpërndarja e specieve”




Figura 6 - Diagrami e klasës UML, skema e aplikimit të temës “Shpërndarja e specieve”

Lloji kryesor i objektit gjeohapësinor për temën “*Shpërndarja e specieve*” është *NjësiaEShpërndarjesSëSpecieve*. Informacioni mbi shfaqjet e specieve është grumbulluar brenda këtij lloji të objektit gjeohapësinor. Objekti gjeohapësinor i vendosjes së të dhënave të shpërndarjes së specieve specifikon një bazë të dhënash që përmban njësitë e shpërndarjes së specieve.

Grupi Të Dhenave Për Shpërndarjen e Specieve është një grup i paracaktuar i të dhënave, i cili përmban metadata specifike në lidhje me shtrirjen (informacion më të detajuar mbi masën sesa elementi i metadatatave të nivelit të zbulimit në masë), emrin dhe detajet e dokumentacionit, p.sh. për çfarë qëllimi ligjor është krijuar grupi i të dhënave.




Figura 7 - Kodlistat e skemës së aplikimit të temës “Shpërndarja e specieve”

Të dhënat për temën “Shpërndarja e specieve” shpesh përdoren për raportim sipas detyrimeve ligjore. Mundësia për të përfshirë një lidhje me dokumentet ligjore ose dokumentacionin tjetër sigurohet përmes dokumentit bazë nga të dhënat e shpërndarjes së specieve të përcaktuara në objektin gjeohapësinor.

Shpërndarja e specieve në këtë material përcaktohet si “shpërndarje e vendndodhjes” dhe jo si të dhëna të vëzhguara në terren. Prandaj është e rëndësishme të theksohet informacioni mbi vendndodhjen e vëzhgimeve. Informacioni mbi shpërndarjen e specieve grumbullohet duke përdorur rrjete ose shumëkëndësja, madje edhe

poligone nga tema të tjera (p.sh. njësitë administrative, njësitë statistikore, bio-gjeografike ose analitike), mund të lidhet me një tipar abstrakt përmes objektit gjeohapësinor.

Çdo *NjësiaEShpërndarjesSëSpecieve* ka një atribut kompleks *EmriISpecieve*, i cili përmban dy attribute të detyrueshme *IdESpecieveReferencë* dhe *SkemaESpecieveReferencë* që japin informacione përkatësisht për vlerën dhe skemën e klasifikimit që është e zbatueshme për ngjarjen sipas skemës së propozuar. Shumë sisteme të ndryshme klasifikimi ekzistojnë në nivele të ndryshme, skema aktuale e aplikimit përfshin skemën e klasifikimit dhe *Id-të* e specieve të tri sistemeve të njohura evropiane.



Tri sistemet e njohura të klasifikimit evropian janë *BE-Nomen*, *EUNIS* dhe *Natura2000*:

BE-NOMEN

Portali *BE-Nomen* mundëson përdorimin e saktë të emrave të specieve dhe klasifikimin e tyre, për të menaxhuar informacionin mbi kafshët dhe bimët. Ky është inventari i parë i të gjitha taksonëve për speciet evropiane. Portali është një nga rezultatet e projektit *PESI* (Drejtorja e Infrastrukturës Pan-evropiane të Specieve). Qëllimi i këtij projekti ishte integrimi dhe siguri i regjistrave të autoriteteve specifike taksonomike të emrave, që mbështesin menaxhimin e biodiversitetit në Evropë.

EUNIS (European Nature Information System)

Të dhënat e *EUNIS* mblidhen dhe mirëmbahen nga Qendra Evropiane e temave mbi diversitetin biologjik për Agjencinë Evropiane të Mjedisit dhe Rrjetin Evropian të Vëzhgimit dhe Informacionit Mjedisor, që do të përdoren për raportimin mjedisor në ndihmë ndaj procesit *Natura2000* (*Direktivat e Zogjve* dhe *Habitatëve* të *BE-së*) në koordinim me rrjetin Emerald të Konventës së Bernës.

Natura2000

Natura2000 është një rrjet evropian i vendeve me rëndësi ekologjike nën *Direktivën e zogjve* dhe *Direktivën e Habitatëve*, e cila ka për qëllim ruajtjen e biodiversitetit në tokë dhe në det, duke mbrojtur habitatet dhe speciet më të kërcënuara seriozisht në të gjithë Evropën. Ky legjislacion quhet *Direktiva e Habitatëve* dhe plotëson *Direktivën e Zogjve*. Brenda legjislacionit, vëmendje e veçantë i kushtohet dy grupeve të specieve. E para përbëhet nga speciet e faunës, të listuara në *Direktivën e Habitatëve*. Këto përfshijnë një numër gjitarësh detarë dhe peshq të caktuar. Së dyti, gjitarë të ndryshëm të detit janë gjithashtu shumë të rëndësishëm për rrjetin *Natura2000*. Këto mbrohen sipas *Direktivës së zogjve*,

dhe përhapjes së tyre, madhësia e popullatës dhe shpërndarja janë kritere për emërtimin e *Zonave të mbrojtjes speciale* (SPA) që janë pjesë e *Natura2000*.

BE-Nomen është lista kryesore e referencës që duhet të përdoret. Nëse një takson është i shënuar në *BE-Nomen*, kjo referencë duhet të përdoret si zgjedhja e parë. Nëse nuk është e shënuar në *BE-Nomen*, zgjedhja e dytë është *EUNIS*, dhe nëse nuk është e shënuar në *EUNIS* duhet të referohet tek *Natura2000*, ku *EUNIS* dhe *Natura2000* përfshihen në një masë të madhe në *BE-Nomen*. Qëllimi i *BE-Nomen* është të mbulojë të gjitha taksonet evropiane.

Për më tepër, *LlojetEmritTëSpecieve* ka attribute shtesë, një është *IdELokaleESpecieve* e cila është URL me emrin shkencor të përdorur në nomenklaturën kombëtare dhe me një tregues të *SkemaESpecieveLokale*, e cila përcakton konceptin lokal taksonomik. Emri mund të shtohet si një atribut dhe *VleraEKlasifikimit* mund të përdoret për të përcaktuar marrëdhëniet midis konceptit taksonomik lokal dhe konceptit të përcaktuar nga *SkemaESpecieveReferencë*.

Objekti gjeohapësinor *NjësiaEShpërndarjesSëSpecieve*, i atribuohet një shpërndarjeje të atributit *voidable* dhe lejon përshkrimin e më shumë detajeve mbi informacionin e shpërndarjes që i përket një njësie të vetme shpërndarjeje. *LlojiInformacionitTëShpërndarjes* përmban disa attribute të cilat janë me rëndësi për interpretimin e përdoruesit të një objekti të *NjësiaEShpërndarjesSëSpecieve*. Në grupin e zogjve mund të ketë informacione për shpërndarjen e popullatës rezidente. Atributi i *InformacioniShpërndarjes* duhet të përdoret me shumë kujdes pasi ai gjithashtu nënkupton informacion mbi praninë ose mungesën e një speciejë.




Figura 8 - Shembull i pranisë/mungesës (së specieve) në qelizat e rrjetit 1x1 km të grumbulluara nga vëzhgimet

DataType-i *InformacioniShpërndarjes* përfshin atributet e mëposhtme:

KategoriaENgjarjes i referohet kodlistës (*VleratEKategoriveTëNgjarjes*) së kategorive të prezencës ose klasave të boshatisura.

NumriIPopullatës ka një *datatype* (*LlojiINumritTëPopullatës*) që përmban *MetodaENumërimit*, *NjësiaENumërimit* dhe *NumriIPopullatës*. Ku mund të përdoret si informacion shtesë për kategorinë e ngjarjes.

MetodaENumërimit: kodlista *VleratEMetodësSëNumërimit* përcakton parametrat me kategori cilësore të numërimit ose vlerësimeve të madhësisë së popullatës.

NjësiaENumërimit: kodlista *VleratENjësiesSëNumërimit* përfaqësojnë kodlistën *VleratENjësiesSëLlogaritjesSëNenit17* ose kodlista.

VleratENjësiesSëLlogaritjesSëPërgjithshme. Këto kodlista përcaktojnë vlerat për të cilat është numëruar.

NumriIPopullatës: përmban *datatype* *LlojiIVargut* që tregon madhësinë e llogaritur ose të vlerësuar të popullatës duke përdorur kufijtë e sipërm dhe të poshtëm.

StatusiIVendbanimit: Kategoria e statusit të vendbanimit të dukurive merret me informacione rreth vendit dhe dukurive. Vlerat përcaktohen nga *VleratEStatusitTëVendbanimit*.

InformacioniNdikueshëm: Vlera Boolean tregon nëse vendndodhja e një specie është e ndikueshme. Kjo mund të përdoret për të përgjithësuar të dhënat e ndikueshme.

LlojiIPopullatës: kodlista *VleratELlojitTëPopullatës* përcakton qëndrueshmërinë e popullatës sipas kategorive të përcaktuara nga Agjencia Evropiane e Mjedisit.

Në dokumentin zyrtar është bërë një rekomandim që për bimët dhe speciet jomigratore duhet të zgjidhen vlerat e atributit të përhershëm.

MbledhurNga: datë që tregon kur mbledhja e të dhënave ka filluar në një njësi specifike.

MbledhurDeri: datë që tregon kur mbledhja e të dhënave ka përfunduar në një njësi specifike.

Asnjë objekt gjeohapësinor nuk ka një atribut identifikues të detyrueshëm.

NjësiaEShpërndarjesSëSpecieve dhe *GrupiITëDhënaveTëShpërndarjesSëSpecieve* kanë një identifikues 0..1. Nëse identifikuesi sigurohet, ai do të përbëhet nga dy pjesë: hapësira e emrave dhe një *Id* lokale.

Meqenëse çdo njësi shpërndarëse mund të përfaqësohet nga një objekt gjeohapësinor, p.sh.: një njësi administrative ose një zonë e mbrojtur, ekziston mundësia që të lidhen me objektet e tjera gjeohapësinore përmes një reference të objektit të jashtëm.

3.1.3 Katalogu i tipologjive

3.1.3.1 Llojet e emrave të specieve

-- Emri --

Llojet e emrave të specieve

-- Përkufizimi --

Identifikuesi dhe emri shkencor, përfshirë autorin, të marra nga një listë ndërkombëtare referimi (latinisht), dhe emri i përdorur në vend dhe lidhja e konceptit taksonomik me emrin referencë, ID e taksonomit duhet të përmbajë edhe: mbretërinë, klasën, rendin, familjen, gjininë dhe llojin e shkruar në gjuhën latine.

**-- Përshkrimi --**

SkemaESpecieveReferencë e cila është e autorizuar, ofron listën e specieve të referencës e cila përcakton *EmrinESpecieveReferencë* me emrin e tij shkencor, bashkëngjitur autorin, si dhe *IdESpecieveReferencë*. *EmriISpecieveLokale* siguron informacion nomenklatural dhe

taksonomik, në lidhje me emrin e specieve të përdorura në vend dhe konceptet taksonomike të nënkuptuara nga përdorimi i këtij emri sipas një reference të dhënash. Gjithashtu dhe kategorinë e kërcënimit sipas IUCN.

-- Tipi i elementit --

DataType

ATRIBUTET

IdESpecieveReferencë: *VleratEKoditTëSpecieveReferencë*

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Id e specieve referencë

-- Përkufizimi --

Identifikuesi i njëres prej listave të referencave të dhëna nga *SkemaESpecieveReferencë*.

-- Përshkrimi --

Në *SkemaESpecieveReferencë*, *Id*-të e specieve janë të lidhura me emra shkencorë dhe autorët përkatës që përdorin GUID³.

[I detyrueshëm: PO]

SkemaESpecieveReferencë: *VleratESkemësSëSpecieveReferencë*

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Skema e specieve referencë

-- Përkufizimi --

Lista e referencave që përcakton një standard nomenklatural dhe taksonomik, në të cilin do të hartëzohen të gjithë emrat vendorë dhe konceptet taksonomike.

-- Përshkrimi --

Kodlistat të pranuar në referencat taksonomike pan-evropiane që përcaktojnë nomenklaturën dhe konceptin taksonomik të një emri specije të caktuar. Kjo nuk duhet të vlerësohet si e vërteta e fundit taksonomike: kjo gjithmonë do të ndryshojë. Ajo shërben si një përkufizim i një koncepti taksonomik, i përshkruar nga marrëdhëniet sistematike dhe sinonime, ku mund të regjistrohen emra të tjerë dhe koncepte të qenësishme taksonomike. Kodlistat përfshijnë *BE-Nomen*, *EUNIS dhe Natura2000*. Në këto burime GUID-et dhe emrat e harmonizuar mbahen nga institucione me detyrë jashtë INSPIRE dhe emrat e specieve duhet të merren përmes shërbimeve të internetit duke përdorur GUID. Vetëm një nga këto lista duhet të përdoret për një takson. Prioriteti është si vijon:

1. Emri i *BE-së*; 2. *EUNIS*, 3. *Natura2000*. Kjo nënkupton: nëse një takson shënohet në *BE-Nomen*, kjo referencë duhet të përdoret si zgjedhja e parë. Nëse nuk është e shënuar në *BE-Nomen*, zgjedhja e dytë është *EUNIS*, nëse jo në *EUNIS*, mund të përdoret *Natura2000*.

[I detyrueshëm: PO]

EmriISpecieveReferencë: Tekst

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Emri i specieve referencë

-- Përkufizimi --

Emri shkencor, përfshirë autorin, dhe përdoret në *SkemaESpecieveReferencë* të autorizuar.

-- Përshkrimi --

SkemaESpecieveReferencë e cila është e autorizuar (nga *BE-Nomen*, *EUNIS* dhe *direktivat e Natura2000*) siguron kodlistat e specieve të referencave që përcaktojnë *EmriISpecieveReferencë* me emrin e tij shkencor bashkëngjitur autorin, si dhe *IdESpecieveReferencë*.

[I detyrueshëm: PO]

IdLokaleESpecies: *VleratEKoditTëEmritTëSpecieveLokale*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Id lokale e species

-- Përkufizimi --

Identifikuesi i përdorur në nomenklaturën kombëtare.

³ GUID (*Globally Unique Identifier*) – Identifikuesi Unik Global.



ATRIBUTET

-- Përshkrimi --

IdETaksonit e përdorur në databazën e nomenklaturës kombëtare.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *SkemaESpecieveLokale*: Tekst

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Skema e specieve lokale

-- Përkufizimi --

Emri i skemës së klasifikimit të species lokale.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *EmriLokalISpecies*: Tekst

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Emri lokal i species

-- Përkufizimi --

Emri shkencor, përfshirë autorin, i përdorur në nomenklaturën kombëtare me konceptin e tij kombëtar taksonomik.

-- Përshkrimi --

EmriLokalISpecies siguron informacione nominologjike dhe taksonomike, në lidhje me emrin e specieve të përdorura në një vend. Gjithashtu, jep konceptet taksonomike të nënkuptuara nga përdorimi i emrit sipas referencës së dhënë. Nëse hiqet emri dhe koncepti i dhënë nga *IdESpecieveReferencë* sipas *SkemaESpecieveReferencë*, ky informacion mund të përdoret lokalisht.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *Kualifikimi: VleratEKualifikimit*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Kualifikimi

-- Përkufizimi --

Specifikon marrëdhëniet e konceptit taksonomik midis identifikuesit lokal të specieve dhe identifikuesit të specieve referente.

-- Përshkrimi --

Përcakton se si emri lokal i specieve lidhet në mënyrë konceptuale me *IdESpecieveReferencë* dhe merr vlerat: kongruente, e përfshirë në, përfshin, mbivendoset ose përjashton.

[I detyrueshëm: PO]

3.1.3.2 Lloji i informacionit të shpërndarjes

-- Emri --

Lloji i informacionit të shpërndarjes

-- Përkufizimi --

Përshkrimi i statusit të subjektit të shpërndarjes brenda njësisë të shpërndarjes së specieve, përfshin zhvillimin, për të vlerësuar ose llogaritur numrin e dukurive ose madhësinë e popullatës së specieve të veçanta.

-- Tipi i elementit --

DataType

LIDHJE STRUKTURE TË BRENDSHME

→ Gjeneruar nga «*dataType*» LlojetEPopullatës tek «*dataType*» LlojiInformacionitTëShpërndarjes

ATRIBUTET

◆ *KategoriaENgjarjes*: VleratEKategorisëSëNgjarjes

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Kategoria e ngjarjes

-- Përkufizimi --

Dendësia e popullatës së specieve në njësinë e shpërndarjes së specieve.

-- Përshkrimi --

Zhvillimi i një specie (dendësia e popullatës) në klasa (e zakonshme, e rrallë, shumë e rrallë, e pranishme ose në mungesë) në njësi individuale të shpërndarjes së specieve.



ATRIBUTET

[I detyrueshëm: PO]

◆ *StatusiIVendbanimit: VleratEStatusitSëVendbanimit*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- **Emri** --

Statusi i vendbanimit

-- **Përkufizimi** --

Informacion mbi statusin e vendbanimit të një specie në lidhje me vendqëndrimin dhe qëndrueshmërinë.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *NumriIPopullatës: LlojiINumritTëPopullatës*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- **Emri** --

Numri i popullatës

-- **Përkufizimi** --

Një varg vlerash që tregon dukuritë e llogaritura, të vlerësuara të madhësive të popullatës, duke përdorur një kufi të sipërm dhe të poshtëm.

-- **Përshkrimi** --

Një vlerë e densitetit varg për shfaqjen e specieve, në njësitë individuale të shpërndarjes së specieve, që llogaritet ose vlerësohet duke u bazuar në njësitë e përcaktuara të numërimit, ose duke përdorur kufijtë e sipërm dhe të poshtëm.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *InformacioniINdjeshëm: Boolean*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- **Emri** --

Informacioni i ndjeshëm

-- **Përkufizimi** --

Vlerat Boolean që tregon nëse vendndodhja e një specie specifike është e ndjeshme.

-- **Përshkrimi** --

Kjo mund të përdoret për të filtruar ose përgjithësuar të dhënat e ndjeshme. Përfaqësimet e përgjithësuara mund të jenë objekte gjeohapësinore të mëdha p.sh. qelizat e rrjetit.

Shënim. Vendndodhja e specieve p.sh. vendndodhja e mbarështimit, e specieve të prekshme, të rrezikuara ose të mbrojtura me ligj, mund të përjashtohen nga shpërndarja ose të përgjithësohen në mënyrë gjeohapësinore nga vendndodhjet e detajuara, deri në rezolucionet më të ulëta, në qelizat më të gjëra të rrjetit për të shmangur një krim mjedisor.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *LlojiIPopullatës: VleratELlojitTëPopullatës*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- **Emri** --

Lloji i popullatës

-- **Përkufizimi** --

Qëndrueshmëria e popullatave, veçanërisht në lidhje me speciet migratore, brenda një njësie të shpërndarjes së specieve.

-- **Përshkrimi** --

Llojet e shfaqjes së specieve ose të të dhënave të popullatës që mblidhen.

Shembull: I përherëshëm, shtegtar, lloj i huaj, lloj i huaj invaziv.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *MbledhurNga: Datë*

Shumëllojshmëria: [1]

-- **Emri** --

Mbledhur nga

-- **Përkufizimi** --

Data kur filloi mbledhja e të dhënave për shfaqjen e specieve vendase.

-- **Përshkrimi** --

Data e fillimit për mbledhjen/regjistrimin e të dhënave kryesore të shfaqjes së specieve.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *MbledhurDeri: Datë*

Shumëllojshmëria: [1]

-- **Emri** --

Mbledhur deri

-- **Përkufizimi** --

Data kur ka përfunduar mbledhja e të dhënave për shfaqjen e specieve vendase.

**ATRIBUTET****-- Përshkrimi --**

Data e fundit për mbledhjen/regjistrimin e të dhënave kryesore të shfaqjes së specieve.

[I detyrueshëm: PO]

3.1.3.3 Lloji i numrit të popullatës**-- Emri --**

Lloji i numrit të popullatës

-- Përkufizimi --

Një varg vlerash që tregon dukuritë e llogaritura, të vlerësuara për madhësinë e popullatës, e cila përcaktohet nga një kufi i sipërm dhe i poshtëm.

-- Përshkrimi --

Një vlerë e densitetit të vargut për shfaqjen e specieve në njësitë individuale të shpërndarjes së specieve, vlerësohet ose llogaritet bazuar në njësitë e përcaktuara të numërimit, ose duke përdorur kufijtë e sipërm dhe të poshtëm.

-- Tipi i elementit --

DataType

ATRIBUTET

MetodaENumërimit: VleraEMetodësSëLlogaritjes

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Metoda e numërimit

-- Përkufizimi --

Metoda e sigurimit të një numri për tregimin e zhvillimit të një specie brenda një njësie specifike të shpërndarjes së specieve.

-- Përshkrimi --

Për të marrë një vlerësim të densitetit ose zhvillimit, ku ofruesi i grupit të të dhënave mund të llogarisë ose vlerësojë zhvillimin e popullatës.

[I detyrueshëm: PO]

NjësiaENumërimit: VleratENjësiesSëLlogaritjes

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Njësia e numërimit

-- Përkufizimi --

Çfarë është numëruar, vlerësuar ose llogaritur kur përpilohen informacione për zhvillimin e një specie brenda njësies së shpërndarjes së specieve.

-- Përshkrimi --

Ky parametër përcakton cilat njësi të popullatës së specieve janë mbledhur ose marrë.

Shembull. Koloni, individë, larva, çifte, tufa.

[I detyrueshëm: PO]

NumriIPopullatës: LlojiIVargut

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Numri i popullatës

-- Përkufizimi --

Një varg vlerash që tregon dukuritë e numëruara, të vlerësuara ose të llogaritura të madhësive të popullatës duke përdorur kufijtë e sipërm dhe të poshtëm.

-- Përshkrimi --

Një varg vlerash të densitetit të shfaqjes së specieve, në njësitë individuale të shpërndarjes së specieve të numëruara, ose të llogaritura, bazuar në njësitë e përcaktuara të numërimit duke përdorur kufijtë e sipërm dhe të poshtëm.

[I detyrueshëm: PO]



3.1.3.4 Lloji i vargut

-- Emri --

Lloji i vargut

-- Përkufizimi --

Vlera që tregon kufijtë e sipërm dhe të poshtëm të numërimit, vlerësimit ose llogaritjes së dukurive.

-- Tipi i elementit --

DataType

ATRIBUTET

◆ *KufiriSipërm: Integer*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Kufiri i sipërm

-- Përkufizimi --

Kufiri i sipërm i diapazonit. Nëse vlera e këtij atributi është e pavlefshme dhe e ulët, kjo nënkupton që vlera është midis nivelit të ulët dhe pafundësisë.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *KufiriPoshtëm: Integer*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Kufiri i poshtëm

-- Përkufizimi --

Kufiri i poshtëm i diapazonit. Nëse vlera e këtij atributi është e pavlefshme dhe e sipërme, kjo nënkupton se vlera është midis nivelit të sipërm dhe zeros.

[I detyrueshëm: PO]

3.1.3.5 Grupi i të dhënave për shpërndarjen e specieve

-- Emri --

Grupi i të dhënave për shpërndarjen e specieve

-- Përkufizimi --

Ky grup i të dhënave është një koleksion i objekteve (njësive) individuale gjeohapësinore në një shpërndarje të specieve.

-- Përshkrimi --

Mbledhja e objekteve individuale gjeohapësinore të gjeometrisë së lejuar, ku ndodhet një specie.

-- Tipi i elementit --

FeatureType

LIDHJE STRUKTURORE TË BRENDSHME

➔ Agreguar nga «*featureType*» *NjësiaEShpërndarjesSëSpecieve* tek «*featureType*» *GrupiTëDhënavePërShpërndarjenESpecieve*

ATTRIBUTE

◆ *InspireId: Identifikues*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Inspire Id

-- Përkufizimi --

Identifikimi i objektit të jashtëm të objektit gjeohapësinor.

-- Përshkrimi --

Një identifikues i objektit të jashtëm është një identifikues unik i objektit, i publikuar nga autoriteti përgjegjës, i cili mund të përdoret nga aplikimet e jashtme për të referuar objektin gjeohapësinor. Identifikuesi është një identifikues i objektit gjeohapësinor, jo një identifikues i fenomenit në realitet.

[I detyrueshëm: PO]

◆ Emri: Tekst

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Emri



ATTRIBUTE

-- Përkufizimi --

Emri i një grupi të dhënash specifike të parashikuara për “*Shpërndarjen e specieve*”.

-- Përshkrimi --

Një emër identifikues i shkurtër që përshkruan një bazë të dhënash specifike të siguruar nga një institucion.

Shembulli 1: Speciet e listës së kuqe në Norvegji.

Shembulli 2: Speciet pushtuese të huaja që ndodhen në Irlandë.

Shembulli 3: Artikulli 17 Raporti në Gjermani.

[I detyrueshëm: PO]

ShtrirjaEDomeinit: MultiSurface

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Shtrirja e *domein-it*

-- Përkufizimi --

Shtrirja gjeografike e *domein-it* të tipologjisë së koleksionit.

[I detyrueshëm: PO]

FillimiICiklitJetësor: Datë-Orë

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Fillimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --

Data dhe ora në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor është futur ose ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore.

-- Përshkrimi --

Shënim. Kjo datë është regjistruar për të mundësuar gjenerimin e skedarëve vetëm të azhurnimit të ndryshimit.

[I detyrueshëm: PO]

PërfundimiICiklitJetësor: Datë-Orë

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Përfundimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --

-- Identifikuesi --

<http://inspire.ec.europa.eu/codeList/OccurrenceCategoryValue>

-- Vlerat --

Vlerat e lejuara për këtë kodlistë përmbajnë çdo vlerë të përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

KODLISTË
-- Emri --
I zakonshëm
-- Përkufizimi --
Speciet vlerësohen si të zakonshme në njësinë e shpërndarjes së specieve nga ofruesi i të dhënave.
-- Emri --
I rrallë
-- Përkufizimi --
Speciet vlerësohen si të rralla në njësinë e shpërndarjes nga ofruesi i të dhënave.
-- Emri --
Shumë e rrallë
-- Përkufizimi --
Speciet vlerësohen si shumë të rralla në njësinë e shpërndarjes nga ofruesi i të dhënave.
-- Emri --
I pranishëm
-- Përkufizimi --
Lloji është i pranishëm në njësinë e shpërndarjes së specieve.
-- Emri --
Mungon
-- Përkufizimi --
Speciet janë kontrolluar, por nuk janë gjetur në <i>Njësinë e Shpërndarjes së Specieve</i> .

4.2.1.4 Vlerat e kualifikimit

-- Emri --

Vlera e kualifikimit

-- Përkufizimi --

Kjo vlerë përcakton lidhjen midis koncepteve taksonomike të një emri specie vendore, dhe emrit të specieve referencë.

-- Identifikuesi --

<http://inspire.ec.europa.eu/codeList/QualifierValue>

-- Vlerat --



Vlerat e lejuara për këtë kodlistë përmbajnë çdo vlerë të përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

KODLISTË
-- Emri -- Në harmoni
-- Përkufizimi -- Konceptet taksonomike janë identike.
-- Emri -- Përfshirë në
-- Përkufizimi -- Koncepti taksonomik i <i>EmriLokallSpecieve</i> përfshihet në konceptin e <i>EmriISpecieveReferencë</i> .
-- Emri -- Përfshin
-- Përkufizimi -- Koncepti taksonomik i <i>EmriLokallSpecieve</i> përfshin konceptin e <i>EmriISpecieveReferencë</i> .
-- Emri -- Mbivendosje
-- Përkufizimi -- Konceptet taksonomike pjesërisht mbivendosen, por secila prej tyre ka një pjesë që nuk përfshihet në tjetrën.
-- Emri -- Përfshihet
-- Përkufizimi -- Konceptet taksonomike përfshihen njëra-tjetrën.

4.2.1.5 Vlerat e skemës së referencës së specieve

-- Emri --

Vlera e skemës së referencës së specieve

-- Përkufizimi --

Lista e referencave që përcaktojnë një standard nomenklatural dhe taksonomik, në të cilin mund të hartohen emrat vendorë dhe konceptet taksonomike.

-- Përshkrimi --

SkemaESpecieveReferencës e autorizuar ofron listën e specieve referente që përcakton emrin e specieve të referencës me emrin e saj shkencor plus autorin dhe speciet e referencës. Në këto *SkemaESpecieveReferencës* emrave të specieve të harmonizuara u jepen udhëzues dhe emrat e specieve duhet të merren përmes shërbimeve të *web-it* duke përdorur *GUID*. Vetëm një nga këto lista duhet të përdoren për një takson. Prioriteti është si vijon:

1. Emrat e *BE-së*;
2. *EUNIS*;
3. *Direktiva e Natura2000*.

Kjo nënkupton se, nëse një takson është e shënuar në *BE-Nomen*, kjo referencë duhet të përdoret si zgjedhja e parë. Nëse nuk është e shënuar në *BE-Nomen*, zgjedhja e dytë është *EUNIS*, nëse jo në *EUNIS*, mund të përdoren *Direktiva Natura2000*. Prioriteti do të vijojë si më poshtë, nëse një takson është i shënuar në *BE-Nomen*, kjo referencë duhet të përdoret si zgjedhja e parë. Nëse nuk është e shënuar në *BE-Nomen*, zgjedhja e dytë është *EUNIS*, nëse jo në *EUNIS*, mund të përdoret *Natura2000*.

-- Identifikuesi --

<http://inspire.ec.europa.eu/codeList/ReferenceSpeciesSchemeValue>

-- Vlerat --

Vlerat e lejuara për këtë kodlistë përmbajnë çdo vlerë të përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

KODLISTË
-- Emri -- <i>BE-Nomen</i>
-- Përkufizimi -- Emrat dhe konceptet taksonomike siç përcaktohen nga inventari pan-evropian i specieve, botuar nga portali <i>BE-Nomen</i> .
-- Emri -- <i>EUNIS</i>
-- Përkufizimi -- Emrat dhe konceptet taksonomike siç përcaktohen nga lista e specieve <i>EUNIS</i> .

**KODLISTË****-- Emri --**

Direktivat e natyrës

-- Përkufizimi --Emrat dhe konceptet taksonomike siç përcaktohen nga listat e specieve në *direktivat 2009/147/EC (Direktiva e Zogjive)* dhe *92/43/KEE (Direktiva e Habitave)*.**4.2.1.6 Vlerat e statusit të rezidencës****-- Emri --**

Vlera e statusit të rezidencës

-- Përkufizimi --

Kategoria e vendbanimit të dukurive ose popullatës së vlerësuar brenda një njësie të caktuar të grumbullimit.

-- Përkufizimi --Këto vlera përdoren për *Natura2000*.

Shënim. Një ose më shumë kategori të popullatës mund të renditen në bazën e të dhënave, duke i dhënë madhësinë e popullatës p.sh. popullata e përhershme dhe dimërore.

-- Identifikuesi --<http://inspire.ec.europa.eu/codeList/ResidencyStatusValue>**-- Vlerat --**

Vlerat e lejuara për këtë kodlistë përmbajnë çdo vlerë të përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

KODLISTË**-- Emri --**

Kultivuar

-- Përkufizimi --Speciet kultivohen në një njësi gjeohapësinore të përcaktuar nga *NjësiaEShpërndarjesSëSpecieve*.**-- Emri --**

I zhdukur

-- Përkufizimi --Speciet janë zhdukur në njësinë hapësinore të përcaktuar nga *NjësiaEShpërndarjesSëSpecieve*.**-- Emri --**

I vendosur

-- Përkufizimi --Speciet janë prezantuar dhe po riprodhohen me popullata të qëndrueshme në njësinë gjeohapësinore të përcaktuar nga *NjësiaEShpërndarjesSëSpecieve*.**-- Emri --**

I përkohshëm

-- Përkufizimi --Speciet janë prezantuar, por nuk ka popullata të qëndrueshme, për t'u riprodhuar në njësinë hapësinore të përcaktuar nga *NjësiaEShpërndarjesSëSpecieve*.**-- Emri --**

Vendas

-- Përkufizimi --Speciet po ndodhen në vend në njësinë gjeohapësinore të përcaktuar nga *NjësiaEShpërndarjesSëSpecieve*.**-- Emri --**

I paqëndrueshëm

-- Përkufizimi --

Speciet paraqiten natyrshëm (nga migrimi natyror), por nuk ka popullata të qëndrueshme.

-- Emri --

Ndoshta i zhdukur

-- Përkufizimi --Speciet nuk janë vërejtur nga anketat e fundit, por asnjë provë pozitive e zhdukjes nuk është e mundur në njësinë gjeohapësinore të përcaktuar nga *NjësiaEShpërndarjesSëSpecieve*.**-- Emri --**

Riprezantuar ose translokuar

**KODLISTË****-- Përkufizimi --**

Një popullatë e zhdukur dhe një specie e dikurshme vendase është ri prezantuar si një masë për ruajtjen e natyrës në njësinë gjeohapësinore të përcaktuar nga *Njësia E Shpërndarjes Së Specie*.

4.2.2 Skema e aplikimit, shpërndarja e specieve shtesë**KODLISTAT**

Vlera E Përgjithshme E Metodës Së Burimit

4.2.2.1 Vlerat e përgjithshme të metodës së burimit**-- Emri --**

Vlerat e përgjithshme e metodës së burimit

-- Përkufizimi --

Metodat që janë përdorur tek burimet për përpilimin e informacionit në lidhje me dukuritë e specieve brenda një njësie të shpërndarjes së specieve.

-- Përshkrimi --

Përshkruan se si është përpiluar informacioni në lidhje me dukuritë e specieve brenda një njësie të shpërndarjes së specieve.

-- Identifikuesi --

<http://inspire.ec.europa.eu/codelist/GeneralSourceMethodValue>

-- Vlerat --

Vlerat e lejuara për këtë kodlistë përmbajnë çdo vlerë të përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

KODLISTË**-- Emri --**

Ekzaminimi i mbledhjes

-- Përkufizimi --

Dukuritë/vëzhgimet e mbledhura nga ekzaminimet e koleksioneve.

-- Përshkrimi --

“Shembull. Herbari, koleksionet zoologjike etj.”

-- Emri --

Hartëzimi i rrjetit

-- Përkufizimi --

Dukuritë/vëzhgimet e mbledhura nga anketimet sistematike në qelizat e rrjetit.

-- Përshkrimi --

Shembull. Programet e mbikëqyrjes në qelizat e rregullta të rrjetit.

-- Emri --

Marrja e mostrave

-- Përkufizimi --

Dukuritë/vëzhgimet e mbledhura nga anketimet sistematike përgjatë traseve lineare.

-- Përshkrimi --

Shembull. Regjistrimet e rregullta të shpendëve.

-- Emri --

Ekzaminimi i literaturës

-- Përkufizimi --

Dukuritë/vëzhgimet e mbledhura si flora, fauna nga atlasat.

-- Përshkrimi --

Shembull. Flora Evropiane.

-- Emri --

Vëzhgime të rastit

-- Përkufizimi --

Ngjarjet/vëzhgimet e mbledhura nga vendet e grumbullimit/vëzhgimit të shpërndara në mënyrë të rastësishme jashtë një studimit sistematik.

-- Përshkrimi --

Shembull. Sistemet e raportimit të specieve.

-- Emri --

Marrja e mostrave statistikore

-- Përkufizimi --

**KODLISTË**

Dukuritë/vëzhgimet e mbledhura në vendet e zgjedhura me metoda statistikore.

-- Përshkrimi --

Shembull: Vendeve të zgjedhura rastësisht për të arritur shifra të paanshme të numrave.

-- Emri --

Parashikimi i modelimit

-- Përkufizimi --

Dukuritë e bazuara në modelet e parashikimit duke përdorur të dhëna që ndodhin në realitet në ndërthurje me parametrat ekologjikë.

-- Emri --

Eksperti vlerësues

-- Përkufizimi --

Vlerësimi i bazuar në mendimin e ekspertit.

URDHËR

Nr. 315, datë 12.10.2023

**PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM
TË KOMPETENCAVE**

Në zbatim të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative, të VKM-së nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, nenit 26, të rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të mëposhtme të titullarit të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave të cilat nuk delegohen dhe që janë të shprehura me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurimit Industrial, z. Mark Ndreca.

2. Z. Mark Ndreca i delegohen kompetencat si më poshtë:

- ndjek dhe zbaton “Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar” (e ndryshuar);

- ndjek dhe monitoron prezencën në punë të personelit të AKSIK-së;

- ndjek detyrat e vendosura në planin mujor;

- merr dhe trajton korrespondencën shkresore.

3. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën nga data 16.10.2023 deri më 21.10.2023.

4. Z. Mark Ndreca nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurimit Industrial.

6. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

7. Ky urdhër hartohet në 3 (tri) kopje të njëjta, një për Protokoll-Arkivin, një për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe një për drejtorin e Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurimit Industrial.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Dorian Tola

URDHËR

Nr. 123, datë 10.10.2023

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“MBI NJË METODË TË PËRBASHKËT
TË SIGURISË PËR VLERËSIMIN E
KONFORMITETIT ME KËRKESAT PËR
MARRJEN E AUTORIZIMIT TË
SIGURISË HEKURUDHORE”**

Në zbatimin të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, pikës 2 dhe shkronjës “b”, pika 4 të nenit 60, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Mbi një metodë të përbashkët të sigurisë për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për marrjen e autorizimit të sigurisë



hekurudhore”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, sipërmarrjet hekurudhore, subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe administratorët e infrastrukturës për ndjekjes dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

RREGULLORE
MBI NJË METODË TË PËRBASHKËT TË
SIGURISË PËR VLERËSIMIN E
KONFORMITETIT ME KËRKESAT PËR
MARRJEN E AUTORIZIMI TË SIGURISË
HEKURUDHORE⁴

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e një metode të përbashkët sigurie për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për marrjen e autorizimit të sigurisë në zbatim të pikës 2 dhe shkronjës “b” të nenit 60, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.

Metoda e përbashkët e sigurisë përfshin:

1. procedurën dhe kriteret për vlerësimin e aplikimeve të bëra nga administratorët e infrastrukturës për marrjen e autorizimit të sigurisë siç përcaktohet në anekset I dhe II të kësaj rregulloreje;

2. parimet për mbikëqyrjen e përputhshmërisë me kërkesat e ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” pasi Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, në vijim Autoriteti, ka dhënë autorizimin e sigurisë, siç përcaktohet në aneksin III të kësaj rregulloreje.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për të gjithë administratorët e infrastrukturës hekurudhore

të cilët operojnë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohet përkufizimi i mëposhtëm:

“Mbikëqyrje” nënkupton masat e aplikuara nga Autoriteti, për të mbikëqyrur performancën e sigurisë, pasi ka dhënë një autorizim sigurie për administratorin e infrastrukturës hekurudhore.

Neni 4
Formulari i aplikimit për autorizim të
sigurisë

Autoriteti njofton administruesit e infrastrukturës për pranimin e aplikimit për autorizim sigurie brenda 48 orëve nga momenti i protokollimit në Autoritet.

Për aplikimin për autorizim sigurie, aplikanti përdor formularin e aplikimit të ofruar nga Autoriteti i cili gjendet në faqen e internetit: www.ash.gov.al

Neni 5
Procedurat për vlerësimin e aplikimeve

1. Gjatë shqyrtimit të kërkesave të paraqitura për autorizim të sigurisë, Autoriteti zbaton procedurat e përcaktuara në aneksin I të kësaj rregulloreje për vlerësimin e përputhshmërisë së tyre me kërkesat e ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”. Autoriteti përdor kriteret e vlerësimit të përcaktuara në aneksin II të kësaj rregulloreje.

2. Gjatë vlerësimit, Autoriteti pranon angazhimet dhe përgjegjësitë e aplikantit për administrimin e rrezeve edhe nëpërmjet përdorimit të kontratave me palët e treta. Kontratat duhet të specifikojnë shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për të garantuar funksionimin e sigurt të mjeteve hekurudhore, veçanërisht në fushat që kanë të bëjnë me administrimin e mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore.

konformitetit me kërkesat për marrjen e një autorizimi të sigurisë hekurudhore”, 32010R1169, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 327/13, datë 11.12.2010.

⁴ Kjo rregullore përaftron plotësisht Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 1169/2010 e 10 dhjetorit 2010, “Mbi një metodë të përbashkët sigurie për vlerësimin e Faqe | 16376



3. Produktet ose shërbimet e ofruara nga kontraktorët ose furnizuesit për administratorët e infrastrukturës duhet të jenë në përputhje me kërkesat e sigurisë. Kontraktorët, furnitorët, ose produktet duhet të jenë të certifikuar në përputhje me skemat përkatëse të certifikimit të vendosura sipas legjislacionit kombëtar për ofrimin e këtyre produkteve dhe shërbimeve.

Neni 6 **Mbikëqyrja**

Pas dhënies së autorizimit të sigurisë, Autoriteti mbikëqyr zbatimin e vazhdueshëm të sistemit të administrimit të sigurisë nga administruesit e infrastrukturës duke zbatuar parimet për mbikëqyrje të përcaktuara në aneksin III të kësaj rregulloreje, si dhe urdhrat dhe udhëzimet përkatëse.

Neni 7 **Privatësia**

Gjatë aplikimit për autorizim sigurie, Autoriteti pranon dokumentacion tregtar i cili mund të jetë i rezervuar. Në rastet kur aplikanti vlerëson se një pjesë e caktuar e aplikimit përmban informacion të rezervuar tregtar, aplikanti duhet që këtë pjesë të aplikimit ta nënshkruajë si “konfidencial”. Nëse pjesë të caktuara të aplikimit nuk vulojnë si të tilla atëherë asnjë pjesë e dokumentacionit nuk do të konsiderohet “konfidenciale”.

Neni 8 **Njoftimi**

Autoriteti informon ministrinë përgjegjëse për transportin dhe Agjencinë e Bashkimit Evropian të Hekurudhave brenda një muaji, mbi autorizimet e sigurisë që janë lëshuar, rinovuar, ndryshuar apo revokuar në zbatim të nenit 66, pika 3 e ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 9 **Vlefshmëria e autorizimit të sigurisë**

Autorizimi i sigurisë i lëshuar nga Autoriteti ka vlefshmëri 5 vjet në zbatim të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 10 **Periudha tranzitore**

Administratorët e infrastrukturës hekurudhore të pajisur aktualisht me licencë kanë detyrim të pajisen me autorizimin e sigurisë brenda 36 muajve, nga hyrja në fuqi e rregullores.

ANEKSI 1 **Procedura për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për marrjen e autorizimeve të sigurisë që do të lëshohen në përputhje me nenin 66, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”**

1. Procedurat e vendosura nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore për të marrë dhe vlerësuar aplikimet për autorizim sigurie dhe për të dhënë autorizim sigurie ndërtohen mbi parimet të mëposhtme.

a) Krijimi dhe rishikimi i procesit të vlerësimit

Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore zhvillon procese të strukturuar dhe të auditueshme që ndërmerren nga persona të përshtatshëm dhe kompetentë. Ai shqyrton aplikimet sipas kritereve të vlerësimit për sistemet e administrimit të sigurisë të përcaktuara në aneksin II.

Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore regjistron vendimet për autorizim të sigurisë dhe jep arsyetimin për çdo vendim që merr.

Procesi i përgjithshëm i vlerësimit nga ana e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore rishikohet periodikisht me qëllim përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të tij.

b) Cilësia e procesit të vlerësimit

Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore monitoron cilësinë e performancës në fazat kryesore të shqyrtimit të kërkesave për autorizime sigurie.

c) Qëllimi i vlerësimit

Vlerësimi është në nivel të sistemit të administrimit dhe procesit të mbikëqyrjes. Kur shqyrtimi zbulon mangësi, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore ushtron diskrecion (trajtim i çështjes me matun) dhe, në varësi të natyrës dhe seriozitetit të mospërputhjes, tregon pikat që duhet të përmirësohen. Në fund, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore ushtron fuqinë e tij për të refuzuar një aplikim.

Vlerësimi është:



i. në përshtatje me rreziqet, karakterin dhe shtrirjen e operacioneve të aplikantit;

ii. i bazuar në vlerësimet e aftësisë së përgjithshme të administratorit të infrastrukturës për të vepruar në mënyrë të sigurt siç përshkruhet në sistemin e tij të administrimit të sigurisë.

ç) Koha e vlerësimit

Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore përfundon vlerësimin brenda kohës së kërkuar nga neni 67, pika 1 e ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, ndërkohë që siguron se provat e ofruara nga aplikanti janë shqyrtuar mjaftueshëm. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore gjatë fazës së vlerësimit informon administruesin e infrastrukturës për mangësitë e mëdha sa më shpejt të jetë e mundur.

d) Vendimarrja gjatë vlerësimit

i. Vendimi për të pranuar ose refuzuar një kërkesë për autorizim të sigurisë bazohet në provat e ofruara nga aplikanti nëse ai ka treguar ose jo pajtueshmëri me kërkesat përkatëse.

ii. Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore vlerëson nëse përmbledhja e bashkangjitur e manualit të sistemit të administrimit të sigurisë lejon një gjykim fillestar mbi cilësinë dhe përshtatshmërinë e sistemit të administrimit të sigurisë dhe vendos se në cilat fusha nevojiten informacione të mëtejshme.

Gjatë vlerësimit të aplikimit Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, për të ndihmuar vlerësimin, mund të kërkojë informacion të detajuar sa herë e shih të arsyeshme dhe të nevojshme.

3. Kur jepet një autorizim sigurie, përputhshmëria e sistemit të administrimit të sigurisë së aplikantit me kriteret e vlerësimit dokumentohet në lidhje me secilin kriter vlerësimi.

4. Kur identifikon një pikë të dyshimtë ose mospërputhje të mundshme, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore specifikon dhe ndihmon aplikantin të kuptojë nivelin e detajeve të pritura në përgjigjet e tij. Për ta bërë këtë:

a) u referohet me saktësi kriterëve përkatëse dhe sigurohet që aplikanti ka kuptuar qartë fushat e identifikuar të mospërputhjes;

b) identifikon pjesën përkatëse të rregulloreve, rregullave dhe standardeve përkatëse;

c) deklaron pse nuk plotësohet kriteri i vlerësimit;

d) dakordësohet për përgjegjësitë e mëtejshme, informacionet dhe çdo provë mbështetëse që sigurohet, siç kërkohet nga niveli e detajuar të kriterëve, dhe specifikon veprimet e aplikantit për të

korrigjuar mangësitë dhe afatin kohor për pajtueshmërinë me kriteret;

e) specifikon fushat të cilat mund t'i nënshtrohen shqyrtimit të mëtejshëm nëpërmjet mbikëqyrjes pas dhënies së autorizimit.

ANEKSI 2

Kriteret për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për marrjen e autorizimeve të sigurisë që duhet të lëshohen në përputhje me nenin 66, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”

A) Masat e kontrollit të rrezikut për të gjitha rreziqet në lidhje me aktivitetet e administrimit të infrastrukturës

1. Ka procedura për të identifikuar rreziqet që lidhen me operacionet hekurudhore, duke përfshirë ato që rrjedhin drejtpërdrejt nga aktivitetet e punës, caktimi i punës ose ngarkesa e punës dhe aktivitetet e subjekteve/personave të tjerë.

2. Ka procedura për zhvillimin dhe vendosjen e masave të kontrollit të rrezikut.

3. Ka procedura për të monitoruar efektivitetin e rregullimeve të kontrollit të rrezikut dhe për të zbatuar ndryshimet kur kërkohet.

4. Ka procedura të vendosura për të njohur nevojën për të punuar së bashku me subjekte të tjera (si: sipërmarrjet hekurudhore, prodhuesi, furnizuesi i mirëmbajtjes, subjekti përgjegjës për mirëmbajtjen, mbajtësi i automjeteve hekurudhore, ofruesi i shërbimit dhe enti i prokurimit), kur është e përshtatshme, për çështjet kur ato kanë ndërveprime të përbashkëta që ka të ngjarë të ndikojnë në vendosjen e masave adekuate të kontrollit të rrezikut në përputhje me nenin 58, ligji nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.

5. Ka procedura për dokumentacionin dhe komunikimin e rënë dakord me subjektet përkatëse, duke përfshirë identifikimin e roleve dhe përgjegjësi të çdo subjekti pjesëmarrës dhe specifikimet për shkëmbimin e informacionit.

6. Ka procedura për të monitoruar efektivitetin e këtyre marrëveshjeve dhe për të zbatuar ndryshimet kur kërkohet.

B) Kontrolli i rrezikut lidhur me afrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe materialeve



1. Ka procedura për nxjerrjen e kërkesave / standardeve/proceseve të mirëmbajtjes nga të dhënat e sigurisë.

2. Ka procedura për të përshtatur intervalet e mirëmbajtjes sipas llojit dhe masës së shërbimit të kryer.

3. Ka procedura për të siguruar që përgjegjësia për mirëmbajtje është e përcaktuar qartë për të identifikuar kompetencat e nevojshme për vendet e mirëmbajtjes dhe për të caktuar nivelet e duhura të përgjegjësisë.

4. Ka procedura për të mbledhur informacione për keqfunksionimet dhe defektet që dalin nga funksionimi i përditshëm dhe për t'i raportuar ato tek ata që janë përgjegjës për mirëmbajtjen.

5. Ka procedura për identifikimin dhe raportimin e rreziqeve që rrjedhin nga defektet dhe mospërputhjet ose mosfunksionimet e ndërtimit gjatë gjithë ciklit të shfrytëzimit të palët e interesuara.

6. Ka procedura për të verifikuar dhe kontrolluar performancën dhe rezultatet e mirëmbajtjes për të siguruar që ato janë në përputhje me standardet e subjektit.

C) Kontrolli i rrezikut lidhur me kontraktorët dhe kontrolli i furnizuesve

1. Ka procedura për verifikimin e kompetencës të kontraktorëve (përfshirë nën kontraktorët) dhe furnitorët.

2. Ka procedura për të verifikuar dhe kontrolluar performancën e sigurisë dhe rezultatet e të gjitha shërbimeve dhe produkteve të kontraktuara të ofruara nga kontraktori ose furnizuesi për të siguruar që ato janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kontratë.

3. Përgjegjësitë dhe detyrat në lidhje me çështjet e sigurisë hekurudhore janë të përcaktuara qartë, të njohura dhe të ndara ndërmjet partnerëve kontraktues dhe ndërmjet të gjitha palëve të tjera të interesuara.

4. Ka procedura për të garantuar gjurmueshmërinë e dokumenteve dhe kontratave që lidhen me sigurinë.

5. Ka procedura për të siguruar që detyrat e sigurisë, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit të lidhur me sigurinë, të kryhen nga kontraktorët ose furnizuesi sipas kërkesave përkatëse të përcaktuara në kontratë.

Ç) Rreziqet nga aktivitetet e palëve të tjera jashtë sistemit hekurudhor

1. Ka procedura për të identifikuar rreziqet e mundshme nga palët e jashtme të sistemit hekurudhor aty ku është e përshtatshme dhe e arsyeshme.

2. Ka procedura për të vendosur masa kontrolli për të zbutur rreziqet e identifikuara në pikën 1, në këtë ndarje, për sa u përket përgjegjësive të aplikantit.

3. Ka procedura për monitorimin e efektivitetit të masave të identifikuara në pikën 2, në këtë ndarje dhe zbatimin e ndryshimeve aty ku është e nevojshme.

D) Dokumentacioni i sistemit të administrimit të sigurisë

1. Ka një përshkrim të aktivitetit që bën të qartë llojin, shtrirjen dhe rrezikun e funksionimit.

2. Ka një përshkrim të strukturës së sistemit të administrimit të sigurisë, duke përfshirë ndarjen e roleve dhe përgjegjësive.

3. Ka një përshkrim të procedurave të sistemit të administrimit të sigurisë që kërkohet nga neni 64, ligji nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, në përputhje me llojin dhe shtrirjen e shërbimeve të operuara.

4. Proceset dhe detyrat kritike për sigurinë që lidhen me llojin e aktivitetit/shërbimit janë renditur dhe përshkruar shkurtimisht.

DH) Shpërndarja e përgjegjësive

1. Ka një përshkrim se si sigurohet koordinimi i aktiviteteve të sistemit të administrimit të sigurisë në të gjithë subjektin, bazuar në njohuritë e provuara dhe përgjegjësinë drejtuese në nivel menaxherial.

2. Ka procedura për të siguruar që personeli me përgjegjësi të deleguara brenda subjektit të ketë autoritetin, kompetencën dhe burimet e duhura për të përmbushur detyrën e tyre.

3. Janë të përcaktuara qartë fushat e përgjegjësisë që lidhen me sigurinë dhe shpërndarjen e përgjegjësive në funksione specifike që lidhen me to, së bashku me ndërveprimet e tyre.

4. Ka një procedurë për të siguruar që detyrat e sigurisë të përcaktohen qartë dhe t'i delegohen personelit me kompetencën e duhur.

E) Sigurimi i kontrollit të administrimit të niveleve të ndryshme

1. Ka një përshkrim se si ndahen përgjegjësitë për çdo proces të lidhur me sigurinë në të gjithë subjektin.



2. Ka një procedurë për monitorimin e rregullt të performancës së detyrave të siguruar nga zinxhiri i administrimit të linjës që duhet të ndërhyjë nëse detyrat nuk po kryhen siç duhet.

3. Ka procedura për të identifikuar dhe administruar ndikimin e aktiviteteve të tjera në sistemin e administrimit të sigurisë.

4. Ka procedura për t'i mbajtur ata që kanë një rol përgjegjës në administrimin e sigurisë për performancën e tyre.

5. Ka procedura për shpërndarjen e burimeve për kryerjen e detyrave sipas sistemit të administrimit të sigurisë.

Ë) Përfshirja e stafit dhe përfaqësuesve të tyre në të gjitha nivelet

1. Ka procedura për të siguruar që stafi dhe përfaqësuesit e stafit të përfaqësohen dhe konsultohen në mënyrë adekuate në përcaktimin, propozimin, rishikimin dhe zhvillimin e aspekteve të sigurisë të procedurave operationale që mund të përfshijnë personelin.

2. Përfshirja e stafit dhe marrëveshjet e konsultimit janë të dokumentuara.

F) Sigurimi i përmirësimit të vazhdueshëm

Ka procedura për të siguruar, aty ku është e mundur, përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të administrimit të sigurisë që përfshijnë:

a) procedurat për rishikimet periodike të sistemit të administrimit të sigurisë, sipas nevojës;

b) procedurat për përshkrimin e masave për monitorimin dhe analizimin e të dhënave përkatëse të sigurisë;

c) procedurat për të përshkruar se si korrigjohen mangësitë e identifikuara;

d) procedurat për përshkrimin e zbatimit të rregullave të reja të administrimit të sigurisë bazuar në zhvillimin dhe mësimet e nxjerra;

e) procedurat për përshkrimin se si përdoren gjetjet e auditimit të brendshëm për të sjellë përmirësim në sistemin e administrimit të sigurisë.

G) Politika e sigurisë e miratuar nga administratori i subjektit dhe i komunikuar të gjithë stafit

Ka një dokument që përshkruan politikën e sigurisë së organizatës dhe është:

a) i komunikuar dhe vënë në dispozicion të gjithë stafit, p.sh. nëpërmjet faqes zyrtare të subjektit apo forma të tjera online;

b) i përshtatshëm për llojin dhe shtrirjen e shërbimit;

c) i miratuar nga shefi ekzekutiv i organizatës.

GJ) Objektivat cilësore dhe sasiorë të subjektit për ruajtjen dhe rritjen e sigurisë, planet dhe procedurat për arritjen e këtyre objektivave

1. Ka procedura për të përcaktuar objektivat përkatës të sigurisë në përputhje me kuadrin ligjor dhe ka një dokument që deklaron këto objektiva.

2. Ka procedura për të përcaktuar objektivat përkatës të sigurisë në përputhje me llojin dhe shtrirjen e operacioneve hekurudhore të mbuluara dhe rreziqet përkatëse.

3. Ka procedura për të vlerësuar rregullisht performancën e përgjithshme të sigurisë në lidhje me objektivat e sigurisë së subjektit dhe me ata të vendosur në nivel kombëtar.

4. Ka procedura për të monitoruar dhe rishikuar rregullisht marrëveshjet operationale, duke:

a) mbledhur të dhënat përkatëse të sigurisë për të nxjerrë tendencat në performancën e sigurisë dhe për të vlerësuar përputhshmërinë me objektivat;

b) interpretuar të dhënave përkatëse dhe zbatuar ndryshimet e nevojshme.

5. Ka procedura nga administratori i infrastrukturës për të zhvilluar plane dhe procedura për arritjen e objektivave të tij.

H) Procedurat për të plotësuar standardet teknike dhe operationale ekzistuese, të reja dhe të ndryshuara

1. Për kërkesat e lidhura me sigurinë që lidhen me llojin dhe shtrirjen e operacioneve, ekzistojnë procedura, për:

a) identifikimin e këtyre kërkesave dhe përditësimin e procedurave përkatëse për të pasqyruar ndryshimet e bëra në to (administrimi i kontrollit të ndryshimit);

b) zbatimin e tyre;

c) monitorimi i pajtueshmërisë me to;

d) marrjen e masave kur evidentohet mospërputhja.

2. Ka procedura për të siguruar që stafi, procedurat, dokumentet specifike, pajisjet dhe mjetet lëvizëse përdoren për qëllimin e synuar.

3. Sistemi i administrimit të sigurisë ka procedura të vendosura për të siguruar që mirëmbajtja të kryhet sipas kërkesave përkatëse.

I) Procedurat dhe metodat për vlerësimin e rrezikut sa herë që një ndryshim i kushteve operationale apo një material i ri sjell rreziqe të reja mbi infrastrukturën



1. Ka procedura administrimi për ndryshime në pajisje, procedura, organizim, personel ose ndërveprim.

2. Ka procedura të vlerësimit të rrezikut për të administruar ndryshimet dhe për të aplikuar Metodatat e Përbashkëta të Sigurisë për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut.

3. Ka procedura për të futur rezultatet e vlerësimit të rrezikut në procese të tjera brenda subjektit dhe për t'i bërë ato të dukshme për stafin përkatës.

J) Sigurimi i programeve dhe sistemeve për trajnimin e stafit në mënyrë që të ruhet kompetenca dhe detyrat të realizohen sipas planit

1. Ka një sistem të administrimit të kompetencave që përfshin të paktën:

a) identifikimi i njohurive dhe aftësive të nevojshme për detyrat që lidhen me sigurinë;

b) parimet e përzgjedhjes (niveli bazë arsimor, aftësia mendore dhe aftësia fizike e nevojshme);

c) trajnimi fillestar dhe certifikimi i kompetencave dhe shkathtësive të fituara;

ç) trajnimi i vazhdueshëm dhe përditësimi periodik i njohurive dhe aftësive ekzistuese;

d) kontrole periodike të kompetencës kur është e përshtatshme;

dh) masa të posaçme në rast aksidentesh / incidentesh ose mungesë të gjatë në punë, sipas nevojës/kur është e nevojshme;

e) trajnime specifike të sistemit të administrimit të sigurisë për stafin e përfshirë drejtpërdrejt në sigurimin që sistemi i administrimit të sigurisë funksionon.

2. Ekzistojnë procedura brenda sistemit të administrimit të kompetencave, që parashikojnë:

a) identifikimin e posteve që kryejnë detyra sigurie;

b) identifikimin e posteve që sjellin përgjegjësi për marrjen e vendimeve operationale brenda sistemit të administrimit të sigurisë;

c) personeli të ketë njohuritë, kompetencat dhe aftësitë e nevojshme (mjekësore dhe psikologjike) të përshtatshme për detyrat e tyre dhe t'i nënshtrohet periodikisht rikualifikimit;

ç) caktimin e stafit me kompetencat e duhura për detyrat përkatëse;

d) monitorimin se si kryhen detyrat dhe zbatimi i veprimeve korrigjuese aty ku kërkohet.

K) Rregullat për dhënien e informacionit të mjaftueshëm brenda subjektit dhe, aty ku është e përshtatshme, midis subjekteve që operojnë në të njëjtën infrastrukturë

1. Ka procedura për të siguruar që:

a) personeli ka njohuri dhe kuptim të sistemit të administrimit të sigurisë dhe informacioni është lehtësisht i aksesueshëm; dhe

b) dokumentacioni i duhur mbi sistemin e administrimit të sigurisë i jepet personelit përkatës të sigurisë.

2. Ka procedura për të siguruar që:

a) informacioni kryesor operacional është relevant dhe i vlefshëm;

b) stafi është i vetëdijshëm për ekzistencën e tij përpara se të aplikohet;

c) është në dispozicion të personelit dhe aty ku kërkohet kopjet u jepen zyrtarisht.

3. Ka marrëveshje për ndarjen e informacionit ndërmjet administratorit të infrastrukturës dhe sipërmarrjeve të tjera hekurudhore.

L) Procedurat dhe formatet për dokumentimin e informacionit të sigurisë dhe përcaktimi i një procedure për kontrollin e konfigurimit të informacionit thelbësor të sigurisë

1. Ka procedura për të siguruar që të gjitha informacionet përkatëse të sigurisë të jenë të sakta, të plota, të qëndrueshme, të lehta për t'u kuptuar, të përditësuara siç duhet dhe të dokumentuara siç duhet.

2. Ka procedura, për:

a) formatimin, generimin, shpërndarjen dhe administrimin e kontrollit të ndryshimeve në të gjithë dokumentacionin përkatës të sigurisë;

b) merr, mbledh dhe ruan të gjithë dokumentacionin/informacionin përkatës në letër ose nga sisteme të tjera regjistrimi.

3. Ka një procedurë për kontrollin e konfigurimit të informacionit jetik të sigurisë.

LL) Procedurat për sigurimin e raportimeve për aksidentet, incidentet dhe ngjarje të tjera të rrezikshme, investigimin dhe analizën e tyre, si dhe marrjen e masave të nevojshme parandaluese

1. Ka procedura për të garantuar që aksidentet, incidentet, rastet e afërta dhe dukuri të tjera të rrezikshme:

a) raportohen, regjistrohen, investigohen dhe analizohen;



b) raportohen, siç kërkohet nga legjislacioni përkatës, tek organet kombëtare.

2. Ka procedura për të siguruar që:

a) rekomandimet nga Autoriteti Kombëtar i Sigurisë, nga Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare dhe nga industria/investigimet e brendshme vlerësohen dhe zbatohen nëse është e përshtatshme;

b) merren parasysh dhe konsiderohen raportet / informacionet përkatëse nga sipërmarrjet e tjera hekurudhore, administratorët e infrastrukturës, subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe mbajtësit e mjeteve hekurudhore.

3. Ka procedura për informacionet përkatëse në lidhje me investigimin dhe shkaqet e aksidenteve, incidenteve dhe dukurive të tjera të rrezikshme që duhet të përdoren për të mësuar dhe, kur kërkohet, për të miratuar masa parandaluese.

M) Ofrimi i planeve për veprim dhe informacion në rastet e emergjencës, i miratuar në bashkëpunim me autoritetet publike përkatëse

1. Një dokument që identifikon të gjitha llojet e emergjencës, duke përfshirë operacionet në mos funksionim si duhet të sistemeve, dhe ka procedura për identifikimin e tyre.

2. Ka procedura të vendosura për të siguruar që, për çdo lloj urgjence të identifikuar:

a) shërbimet e urgjencës mund të kontaktohen menjëherë;

b) shërbimeve të urgjencës u jepen të gjitha informacionet përkatëse si paraprakisht, për të përgatitur reagimin e tyre emergjent, ashtu edhe në momentin e një emergjence.

3. Rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve identifikohen dhe përcaktohen në një dokument.

4. Planet për veprim, sinjalizime dhe informacione ekzistojnë dhe përfshijnë:

a) procedurat për të njoftuar të gjithë stafin me përgjegjësi për menaxhimin e emergjencave;

b) marrëveshjet për t'i komunikuar këto të gjitha palëve, duke përfshirë udhëzimet emergjente për pasagjerët;

c) marrëveshjet për kontaktimin e menjëhershëm të stafit kompetent në mënyrë që ata të mund të marrin çdo vendim të kërkuar.

5. Ka një dokument që përshkruan se si janë alokuar burimet dhe mjetet dhe si janë identifikuar kërkesat për trajnim.

6. Ka procedura për të rivendosur kushtet normale të funksionimit sa më shpejt të jetë e mundur.

7. Ka procedura për testimin e planeve të emergjencës në bashkëpunim me palët e tjera për të trajnuar stafin, procedurat e testimit, identifikimin e pikave të dobëta dhe verifikimin se si menaxhohen situatat e mundshme emergjente.

8. Ka procedura për të koordinuar planet e emergjencës me ndërmarrjet hekurudhore që operojnë në infrastrukturën e organizatës dhe çdo infrastrukturë tjetër me të cilën ajo ka një ndërfaqe.

9. Ka rregullime për ndalimin e menjëhershëm të operimeve dhe trafikut hekurudhor, nëse është e nevojshme, dhe për të informuar të gjitha palët e interesuara për veprimet e ndërmarra.

N) Masat për auditim të brendshëm të sistemit të administrimit të sigurisë

1. Ka një sistem të auditimit të brendshëm i cili është i pavarur dhe i paanshëm dhe që vepron në mënyrë transparente.

2. Ka një plan të auditimeve të brendshme të planifikuara i cili mund të rishikohet në varësi të rezultateve të auditimeve të mëparshme dhe monitorimit të performancës.

3. Ka procedura për identifikimin dhe përzgjedhjen e auditorëve të përshtatshëm.

4. Procedurat janë të vendosura që të:

a) analizojnë dhe vlerësojnë rezultatet e auditimeve;

b) rekomandojnë masat përcjellëse;

c) ndjekin efektivitetin e masave;

d) dokumentojnë ekzekutimin e auditimeve dhe rezultatet e auditimeve.

5. Ka procedura për të siguruar që nivelet e larta të zinxhirit të menaxhimit janë të vetëdijshëm për rezultatet e auditimeve dhe marrin përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin e ndryshimeve në sistemin e menaxhimit të sigurisë.

6. Ka një dokument që tregon se si janë planifikuar auditimet në lidhje me rregullimet rutinë të monitorimit për të siguruar përputhjen me procedurat dhe standardet e brendshme.

NJ) Projektimi i sigurt i infrastrukturës hekurudhore

1. Ka procedura për të siguruar projektimin e sigurt të infrastrukturës gjatë gjithë ciklit të shfrytëzimit të infrastrukturës, duke përfshirë projektimin dhe instalimin.



2. Ka procedura të cilat marrin parasysh ndryshimin teknik të infrastrukturës dhe administrimin e atij ndryshimi.

3. Ka procedura që tregojnë se janë identifikuar rregullat përkatëse që mbulojnë projektimin e infrastrukturës dhe çdo metodë kombëtare të sigurisë dhe se aplikanti mund t'i zbatojë ato.

O) Funksimi i sigurt i infrastrukturës hekurudhore

1. Ka procedura për të siguruar që infrastruktura të administrohet dhe operohet në mënyrë të sigurt, duke marrë parasysh numrin, llojin dhe shtrirjen e operatorëve që kryejnë shërbime në rrjet duke përfshirë të gjitha ndërveprimet e nevojshme në varësi të kompleksitetit të operimit.

2. Ka procedura të cilat tregojnë se si administrohet siguria në kufijtë fizikë dhe/ose operacionalë të infrastrukturës.

3. Ka procedura të cilat tregojnë se sa efektiv administrohet bashkëpunimi dhe koordinimi, si në situata normale ashtu edhe në ato emergjente.

4. Ka procedura që tregojnë se janë identifikuar rregullat që mbulojnë funksionimin dhe administrimin e sigurt të ndërfaqeve të infrastrukturës/mjeteve dhe se aplikanti mund t'i respektojë ato.

P) Sigurimi i mirëmbajtjes dhe materialeve

1. Ka procedura për të siguruar që mirëmbajtja e infrastrukturës të ndërmerret në mënyrë të sigurt, duke përfshirë kontrollin e qartë të administrimit, auditimin dhe inspektimin e dokumentuar.

2. Ka procedura të cilat sigurojnë që mirëmbajtja e infrastrukturës plotëson nevojat specifike të rrjetit.

3. Ka procedura që tregojnë se janë identifikuar rregullat që mbulojnë furnizimin me mirëmbajtje dhe material dhe se aplikanti mund t'i zbatojë ato.

Q) Mirëmbajtja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të trafikut dhe sinjalizimit

1. Ka procedura për të siguruar që sistemi i kontrollit dhe sinjalizimit të trafikut të funksionojë dhe mirëmbahet në mënyrë që të sigurojë funksionimin e sigurt të hekurudhës.

2. Ka procedura për të qenë në përputhje me standardet teknike dhe operacionale ekzistuese, të reja dhe të ndryshuara.

3. Ka procedura të cilat përcaktojnë se si administrohet siguria në kufijtë fizikë dhe/ose operacionalë të sistemit të kontrollit të trafikut dhe sinjalizimit, duke përfshirë mënyrën se si menaxhohet bashkëpunimi, nëse është e nevojshme.

4. Ka procedura që tregojnë se janë identifikuar rregullat që mbulojnë funksionimin dhe mirëmbajtjen e sigurt të sistemit të kontrollit të trafikut dhe sinjalizimit dhe se aplikanti mund t'i zbatojë ato.

ANEKSI 3

Parimet e mbikëqyrjes pas dhënies së autorizimit

1. Qasja e Autoritetit Kombëtarë të Sigurisë ndaj mbikëqyrjes së përputhshmërisë siç përmendet në nenin 58, pika 1, dhe nenin 70, ligji nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", do të bazohet në parimet e mëposhtme. Këto parime zbatohen për kuadrin e aktiviteteve të mbikëqyrjes në tërësi dhe për rastet individuale brenda këtij kuadri.

2. Autoriteti Kombëtarë i Sigurisë zbaton parimin e proporcionalitetit ndërmjet zbatimit dhe rrezikut. Veprimet e ndërmarra për të arritur pajtueshmërinë ose për të vënë në konsideratë administratorët e infrastrukturës për mos përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore do të jenë në proporcion me çdo rrezik për sigurinë ose me seriozitetin e mundshëm të çdo mospërputhjeje, duke përfshirë çdo dëm aktual ose të mundshëm.

3. Autoriteti Kombëtarë i Sigurisë zbaton parimin e konsistencës së qasjes për të siguruar që të marrë një qasje të ngjashme në rrethana të ngjashme për të arritur qëllime të ngjashme.

4. Aktiviteti i mbikëqyrjes së Autoritetit Kombëtar të Sigurisë do të synohet kryesisht në ato aktivitete për të cilat beson se sjellin rreziqet më serioze ose ku rreziqet janë më pak të kontrolluara mirë. Për ta bërë këtë, autoriteti kombëtar i sigurisë do të ketë metoda dhe fuqi për të vlerësuar performancën e përditshme të sigurisë të administratorit të infrastrukturës.

5. Autoriteti Kombëtarë i Sigurisë vendos për prioritetet për të përdorur burimet e tyre në mënyrë efektive dhe veprimi përqendrohet tek ata që janë përgjegjës për rrezikun dhe që janë në gjendje më të mirë për ta kontrolluar atë.

6. Autoriteti Kombëtarë i Sigurisë zbaton parimin e transparencës për të ndihmuar administratorët e infrastrukturës të kuptojnë se çfarë pritet prej tyre (përfshirë atë që duhet ose nuk duhet të bëjnë) dhe çfarë duhet të presin nga Autoriteti Kombëtarë i Sigurisë.



7. Autoriteti Kombëtarë i Sigurisë përgjigjet për vendimet e tij në përputhje me nenin 71 të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” dhe duhet të kenë politika dhe parime me të cilat ato mund të vlerësohen. Për më tepër, Autoriteti Kombëtarë i Sigurisë do të ketë gjithashtu një procedurë ankesash.

8. Autoriteti Kombëtarë i Sigurisë zhvillon marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet e tjera kompetente për të shkëmbyer informacion dhe për të zhvilluar qasje të unifikuara për çështjet që cenojnë sigurinë hekurudhore.

VENDIM

Nr. 40, datë 14.9.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 14.9.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 33 (A) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Agim Lamja

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Hajdar Lamja, Qemal Lamja, Shpëtim Skënderi, Tatjana Skënderi, Myrvete Skënderi, Marseda Skënderi, Emirjan Skënderi,

Agjencia e Trajtimit të Pronave Tiranë, Avokatura e Shtetit

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1907 (285), datë 12.7.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim

të kërkesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, propësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e propësimeve me shkrim të subjekteve të tjera të interesuara, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 757/1996, datë 20.5.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë ligjore për të ndjerin Z.Q., duke njohur si trashëgimtarë ligjorë bashkëshorten Gj.Q. dhe fëmijët C.L. e D.S, kurse me vendimin nr. 8905, datë 21.10.2008 ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë ligjore për të ndjerën C.L., duke njohur si trashëgimtarë ligjorë të saj fëmijët Agim Lamja, H.L. dhe Q.L.

2. Sipas vërtetimit nr. 2546/1 prot., datë 18.7.2011 të Seksionit të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (SAMT), Këshilli i Qarkut Tiranë, shtetasi Z.Sh. (i cili sipas vendimit nr. 4539, datë 20.5.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vërtetimin e faktit juridik është i njëjti person me shtetasin Z.Q.), ka pasur në pronësi rreth 73.000 m² tokë në fshatin Qeha, Komuna Petrelë, Tiranë, përpara zbatimit të ligjit nr. 108, datë 29.8.1945, “Për reformën agrare” (ligji nr. 108/1945). Duke qenë se vërtetimi kadastral nuk kishte të përshkruar kufijtë e pronës, shtetasi Q.L., në cilësinë e trashëgimtarit ligjor, ka kërkuar në gjykatë vërtetimin e faktit juridik të kufijve për këtë sipërfaqe, për efekt të të drejtave që rrjedhin nga ligji nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” (ligji nr. 9235/2004), kërkesë që është pranuar me vendimin nr. 1826, datë 9.3.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka përcaktuar vendndodhjen dhe kufijtë e saj.

3. Me kërkesën e datës 15.12.2008 trashëgimtarët e shtetasit Z.Q. i janë drejtuar Zyrrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, qarku Tiranë për njohjen e së drejtës së pronësisë së trashëgimlënësit të tyre mbi këto pasuri dhe kthimin



ose kompensimin e tyre. Kjo kërkesë i ka kaluar për shqyrtim Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tiranë (AKKP), e cila, me vendimin nr. 230, datë 21.6.2012, ka vendosur rrëzimin e saj dhe mosnjohjen e së drejtës së pronësisë trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar Z.Q. mbi atë pasuri, pasi dokumentacioni hartografik dhe situata tekniko-ligjore në raport me dokumentin kadastral të pronësisë dhe planvendosjen që shoqëron vërtetimin gjyqësor të faktit nuk krijojnë bindjen për pozicionimin e saktë të saj.

4. Kërkuesi Agim Lamja dhe shtetasit D.S., H.L. dhe Q.L. i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt anulimin e vendimit nr. 230, datë 21.6.2012 të AKKP-së dhe njohjen e së drejtës së pronësisë, si dhe kthimin e kompensimin e pasurisë prej 73.000 m². Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7365, datë 27.6.2013, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, duke njohur të drejtën e pronësisë të subjektit të shpronësuar Z.Q. për sipërfaqen 73.000 m², në fshatin Qeha, Komuna Petrelë, Tiranë, sipas planvendosjes bashkëlidhur vendimit, si dhe kthimin e saj paditësve. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim në gjykatën e apelit palët e paditura, AKKP-ja dhe Avokatura e Shtetit.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 3537, datë 27.10.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 7365, datë 27.6.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vlerësuar se arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe se ajo u ka dhënë përgjigje pretendimeve të palëve pasi ka analizuar faktet dhe provat në bazë të dispozitave ligjore të zbatueshme. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs AKKP-ja dhe Avokatura e Shtetit.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1907 (285), datë 12.7.2022, në dhomën e këshillimit, ka vendosur ndryshimin e vendimeve nr. 3537, datë 27.10.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 7365, datë 27.6.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

7. Me kërkesën e datës 25.11.2022, kërkuesi Agim Lamja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës (Mbledhja e Gjyqtarëve), me vendimin nr. 1, datë 17.1.2023, ka vendosur pranimin e kërkesës së një anëtarit të saj për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje.

8. Kolegji i Gjykatës, më datë 20.1.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, duke përcaktuar edhe subjektet e interesuara që do të thirrreshin në gjykim, për njërin prej të cilëve (D.S.) nga shërbimi postar është kthyer njoftimi me shënimin “*është ndarë nga jetë*”. Më datë 12.5.2023, me kërkesë të Gjykatës, trashëgimtarët e këtij subjekti kanë paraqitur aktin e Zyrës së Gjendjes Civile, Bashkia Tiranë, certifikatë vdekjeje nr. 015180882, datë 1.8.2019, sipas të cilit kjo shtetase ka ndërruar jetë më datë 21.11.2017. Në këto kushte, Mbledhja e Gjyqtarëve, në përputhje me nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 dhe dispozitat e nenit 199 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), me vendimin e datës 12.6.2023, pasi ka konstatuar radhën e trashëgimtarëve ligjorë të së ndjerës D.S., ka vendosur të thërrasë në këtë gjykim, në cilësinë e subjekteve të interesuara, shtetasit Shpëtim Skënderi, Tatjana Skënderi, Myrvete Skënderi, Marseda Skënderi dhe Emirjan Skënderi.

9. Më datë 3.5.2023 shtetasit E.A. dhe E.D. kanë paraqitur kërkesë për pjesëmarrje në këtë gjykim kushtetues, në cilësinë e subjekteve të interesuara, duke pretenduar se objekt i këtij gjykimi është prona në të cilën ata janë bashkëpronarë. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 9.5.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar se këta shtetas nuk kanë sjellë argumente për të justifikuar interesin e drejtpërdrejtë në çështjen objekt gjykimi dhe se nga dokumentet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi kushtetues rezulton se ata nuk kanë qenë palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të:

10.1 *Së drejtës për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar të lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, për shkak se nuk është njoftuar për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit, duke u vendosur, në këtë mënyrë, në kushte jo të barabarta me palën tjetër ndërgjyqëse. Kolegji Civil, në mënyrë të njëanshme, ka marrë në shqyrtim dhe ka vlerësuar vetëm pretendimet e palës së paditur në procesin gjyqësor dhe kërkuesi nuk është njoftuar të marrë pjesë në gjykim e të paraqesë prova, argumente dhe



prapësime. Gjykata e Lartë ka njoftuar vetëm revokimin e vendimit të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore dhe ky lloj njoftimi nuk përmbush detyrimin e sekretarisë gjyqësore për njoftimin e rregullt të gjykimit.

10.2 *Së drejtës së aksesit*, pasi Kolegji Civil nuk ka njohur dokumentet arkivore të paraqitura nga pala paditëse në proces, të cilat vërtetoni qenien pronar të trashëgimlënësit të saj dhe nuk ka marrë në konsideratë as vendimin nr. 230, datë 21.6.2012 të AKKP-së, sipas të cilit trashëgimlënësi i kërkuarit është legjitimuar si subjekt i shpronësuar. Ai organ ka ngritur një grup pune dhe ka hetuar në Këshillin e Qarkut Tiranë dokumentet kadastrale dhe fletën e regjistrit, duke vërtetuar saktësinë ligjore të dokumentacionit të paraqitur.

10.3 *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Kolegji Civil ka vlerësuar provat ndryshe nga gjykatat më të ulëta, duke i ndryshuar ato, në tejkalim të kompetencave si gjykatë e ligjit, konkretisht shkresën nr. 2678/3 prot., datë 29.5.2008, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe vërtetimin nr. 2546/1 prot., datë 18.7.2011 të SAMT-së, të Këshillit të Qarkut Tiranë. Është pikërisht vlerësimi që u është bërë këtyre provave që e ka çuar atë gjykatë në konkluzionin e prishjes së vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe mohimin e së drejtës së pronësisë së palës paditëse. Duke rivlerësuar provat, në tejkalim të kompetencave të tij, Kolegji Civil ka arritur në konkluzionin se paditësit nuk kanë legjitimitet aktiv substancial për të kërkuar kthimin dhe kompensimin e pronës të trashëgimlënësit të tyre si ish-pronar dhe se nuk ka pasur të drejta pasurore para datës 29.11.1944.

11. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

11.1 Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u mbrojtur dhe asaj për t'u dëgjuar të lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit* është i pabazuar. Vendimi për revokimin e vendimit të ndërmjetëm për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore u është komunikuar palëve ndërgjyqëse dhe, gjithashtu, është kryer afishimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Kërkuar, pasi ka marrë dijeni për të, ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit mbi të njëjtat shkaqe të ngritura edhe në padi. Ai nuk ka kundërshtuar procedurën e ndjekur nga Kolegji Civil, duke pranuar që shqyrtimi i çështjes të vijojë në dhomën e këshillimit dhe nuk rezulton të

ketë ngritur ndonjë pretendim kundër vendimit të ndërmjetëm. Procesi në Gjykatën e Lartë, përveç faktit që është zhvilluar në dhomën e këshillimit, nuk ka cenuar asnjë të drejtë procedurale të kërkuarit.

11.2 Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës së aksesit* kërkuar nuk provon se është privuar nga e drejta për të parashtruar pretendimet e tij. Ai ka paraqitur parashtrime me shkrim në Gjykatën e Lartë, duke pasur mundësinë të sjellë argumente në mbrojtje të pretendimeve të tij.

11.3 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Kolegji Civil nuk ka marrë prova të reja, por ka vlerësuar provat dhe faktet e administruara nga gjykatat e faktit dhe ka arritur në përfundimin se ato nuk kanë interpretuar drejt dispozitat e ligjit material në lidhje me kërkesat formale dhe substanciale që duhet të plotësohen nga subjekti që pretendon të drejta pronësie.

11.4 Me vendimin e datës 13.3.2023, Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, në kuadër të procedimit penal nr. 3683/2022 për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe 73,000 m², në fshatin Qeha, Petrelë, Tiranë, sipas vendimit nr. 00-2022-1907(285), datë 12.7.2022, të Gjykatës së Lartë.

12. **Subjektet e tjera të interesuara**, Agjencia e Trajtimit të Pronave Tiranë, Hajdar Lamja, Qemal Lamja, Shpëtim Skënderi, Tatjana Skënderi, Myrvete Skënderi, Marseda Skënderi dhe Emirjan Skënderi, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

13. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në



Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Gjykata çmon se kërkuksi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individ i pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën (shih vendimet nr. 12, datë 24.5.2022; nr. 5, datë 22.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese).

16. Gjykata vëren se kërkuksi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, ndërkohë që për pretendimet për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

17. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata vëren se kërkuksi ka kundërshtuar vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 12.7.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur më datë 25.11.2022, pra në dukje jashtë afatit ligjor të lartpërmendur.

18. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në vendimin e datës 9.5.2023, në çështjen “Supergrav Albania” sh.p.k. kundër Shqipërisë (aplikimi nr. 20702/18), ka

gjetur shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në drejtim të së drejtës së aksesit në Gjykatën Kushtetuese, për shkak se kjo e fundit kishte vendosur mospranimin e ankimit kushtetues si të paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor, duke e llogaritur afatin nga data e shpalljes së vendimit nga Gjykata e Lartë, por pa dhënë argumente për këtë qëndrim. Sipas GJEDNJ-së, palët mund të bëjnë ankim nga momenti kur marrin dijeni efektivisht për vendimet gjyqësore dhe në këtë drejtim vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme (shih paragrafët 26-28 të vendimit të GJEDNJ-së në çështjen “Supergrav Albania” sh.p.k. kundër Shqipërisë).

19. Gjykata vëren se në bazë të të dhënave të kontaktit që kërkuksi ka depozituar në Gjykatën e Lartë, me e-mailin e datës 19.10.2022 sekretaria gjyqësore e asaj gjykate i ka komunikuar avokatit të tij vendimin e Kolegjit Civil, objekt kërkesë. Për rrjedhojë, momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave kushtetuese, nga i cili fillon afati i paraqitjes së ankimit kushtetues, konsiderohet data në të cilën kërkuksi është njohur me vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Lartë. Duke llogaritur si të tillë datën 19.10.2022, kur vendimi i arsyetuar i është dërguar zyrtarisht kërkuksit nga administrata e Gjykatës së Lartë, kërkesa konsiderohet se është paraqitur brenda afatit 4-mujor, prandaj kërkuksi përmbush edhe kriterin e legjitimitimit *ratione temporis*.

20. Për sa i takon legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuksi ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u mbrojtur e për t’u dëgjuar të lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, së drejtës së aksesit dhe parimit të gjykatës së caktuar me ligj, të cilat hyjnë në juridiksionin kushtetues. Në drejtim të së drejtës së aksesit kërkuksi ka pretenduar se Kolegji Civil nuk ka njohur dokumentet arkivore të cilat vërtetonin qenien pronar të trashëgimlënësit të tij dhe se nuk ka marrë në konsideratë vendimin e AKKP-së që ka legjitimuar trashëgimlënësin e tij si subjekt të shpronësuar. Gjykata, duke pasur parasysh thelbin dhe natyrën e argumenteve të paraqitura në mbështetje të këtij pretendimi, vlerëson që ta shqyrtojë atë së bashku me parimin e gjykatës së caktuar me ligj. Për rrjedhojë, në vijim do të shqyrtohet bazueshmëria në themel e pretendimit për cenimin e së drejtës për t’u mbrojtur dhe për t’u dëgjuar të lidhur me parimin e barazisë së armëve



dhe kontradiktoritetit, si dhe të atij për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar të lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

21. Kërkuesi ka pretenduar se nuk është njoftuar për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit, duke u vendosur, në këtë mënyrë, në kushte jo të barabarta me palën tjetër ndërgjyqëse. Sipas tij, Kolegji Civil, në mënyrë të njëanshme, ka marrë në shqyrtim dhe ka vlerësuar vetëm pretendimet e palës së paditur në procesin gjyqësor dhe nuk është njoftuar të marrë pjesë në gjykim e të paraqesë prova, argumente dhe prapësime. Gjykata e Lartë ka njoftuar vetëm revokimin e vendimit të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore dhe ky lloj njoftimi nuk përmbush detyrimin e sekretarisë gjyqësore për njoftimin e rregullt të gjykimit.

22. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi vendimi për revokimin e vendimit të ndërmjetëm për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore u është komunikuar palëve ndërgjyqëse dhe afishimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë është kryer. Kërkuesi, pasi ka marrë dijeni për të, ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit mbi të njëjtat shkaqe të ngritura edhe në padi. Ai nuk ka kundërshtuar procedurën e ndjekur nga Kolegji Civil, duke pranuar që shqyrtimi i çështjes të vijojë në dhomën e këshillimit dhe nuk rezulton të ketë ngritur ndonjë pretendim kundër vendimit të ndërmjetëm. Përveçse faktit që është zhvilluar në dhomën e këshillimit, procesi i zhvilluar nga Gjykata e Lartë nuk ka cenuar asnjë të drejtë procedurale të kërkuesit.

23. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare. Kjo e drejtë nuk duhet konsideruar si formale, por, përkundrazi, duhet që palëve gjatë gjykimit t'u jepen

mundësi të barabarta për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njëres palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës tjetër, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 49, datë 22.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se sipas akteve të dosjes gjyqësore, të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, me vendimin e datës 23.5.2017, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është vendosur kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Ky vendim është revokuar me vendimin e datës 16.5.2022 të po atij kolegji. Më datë 2.6.2022, Gjykata e Lartë ka njoftuar paditësit për revokimin e vendimit dhe caktimin e seancës në dhomën e këshillimit (pa praninë e palëve), më datë 20.6.2022, duke i informuar për të drejtën e paraqitjes, brenda 15 ditëve nga marrja dijeni, por jo më vonë se 5 ditë para datës së caktuar për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë, të pretendimeve të tyre me shkrim. Për kërkuesin ky njoftim është nënshkruar nga i vëllai i tij, shtetasi Q.L., më datë 8.6.2022. Pas këtij njoftimi, më datë 16.6.2022, avokati i paditësve (përfshirë edhe kërkuesin) ka paraqitur në Gjykatën e Lartë shpjegime në lidhje me çështjen, duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

25. Gjithashtu, sipas të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, në rubrikën “Çështje të shpallura për gjykim”, në nënrubrikën “Çështje civile” është shpallur lista e seancave për t'u zhvilluar në dhomën e këshillimit të datës 20.6.2022, sipas parashikimeve të nenit 482, pika 3, të KPC-së. Ky njoftim është bërë edhe në ambientet fizike të Gjykatës së Lartë dhe është i administruar në dosjen gjyqësore. Ndërkohë që, po sipas të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezulton se gjykimi i planifikuar për datën 20.6.2022 është shtyrë për një datë tjetër dhe ai është zhvilluar më 12.7.2022.

26. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi është njoftuar rregullisht për datën e shqyrtimit të çështjes së tij në dhomën e këshillimit. Në ushtrim të të drejtave procedurale në procesin civil, paditësit (përfshirë kërkuesin) nëpërmjet avokatit të tyre kanë paraqitur pretendimet dhe prapësimet në lidhje me rekurset e depozituara nga subjektet e interesuara, si



dhe shkaqet për të cilat është kërkuar lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së apelit. Në këto kushte, Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim dhe ka vlerësuar pretendimet e të gjitha palëve ndërgjyqëse në procesin e kundërshtuar dhe kërkuar nuk rezulton të jetë vënë në pozitë të disfavorshme me palën tjetër. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimet për cenimin e së drejtës së mbrojtjes, për t'u dëgjuar të lidhura me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit janë të pabazuara.

B.2 Për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj

27. Sipas kërkesit, Kolegji Civil nuk ka njohur dokumentet arkivore të paraqitura nga pala paditëse në proces, të cilat vërtetonin qenien pronar të trashëgimlënësit të saj dhe nuk ka marrë në konsideratë as vendimin nr. 230, datë 21.6.2012 të AKKP-së, i marrë pas hetimit që ka bërë grupi i punës për dokumentet kadastrale të paraqitura dhe fletën e regjistratit, duke vërtetuar saktësinë ligjore të dokumentacionit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar provat ndryshe nga gjykatat më të ulëta, duke i ndryshuar ato, në tejkalim të kompetencave si gjykatë e ligjit, konkretisht shkresën nr. 2678/3 prot., datë 29.5.2008, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe vërtetimin nr. 2546/1 prot., datë 18.7.2011 të SAMT-së, të Këshillit të Qarkut Tiranë. Është pikërisht vlerësimi që u është bërë këtyre provave që e ka çuar atë gjykatë në konkluzionin e prishjes së vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe mohimin e së drejtës së pronësisë së palës paditëse. Sipas kërkesit, rivlerësimi i provave ka çuar në konkluzionin se paditësit nuk kanë legjitimitet aktiv substancial dhe se nuk kanë pasur të drejta pasurore para datës 29.11.1944.

28. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se Kolegji Civil nuk ka marrë prova të reja, por ka vlerësuar provat dhe faktet e administruara nga gjykatat e faktit dhe ka arritur në përfundimin se ato nuk kanë interpretuar drejt dispozitat e ligjit material në lidhje me kërkesat formale dhe substanciale që duhet të plotësohen nga subjekti që pretendon të drejta pronësie.

29. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj. Ky element, në sensin material, karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë

dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik (*shih vendimet nr. 15, datë 23.3.2023; nr. 3, datë 7.2.2023; nr. 7, datë 23.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë, jurisprudenca kushtetuese ka theksuar se në ushtrimin e funksionit si gjykatë e ligjit, ajo gjykatë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Nëse Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës së faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimin në shkallët më të ulëta gjyqësore, pasi një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj (*shih vendimet nr. 15, datë 23.3.2023; nr. 44, datë 19.7.2016; nr. 36, datë 30.6.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në rastin konkret Gjykata vëren se trashëgimtarët e shtetasit Z.Q. (përfshirë edhe kërkuarësin) i janë drejtuar AKKP-së për njohjen e së drejtës së pronësisë për një sipërfaqe 73.000 m² tokë, në fshatin Qeha, Komuna Petrelë, Tiranë, e cila, me vendimin nr. 230, datë 21.6.2012, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Nga hetimi administrativ rezulton se trashëgimlënësi është klasifikuar si subjekt i shpronësuar, por është konstatuar se dokumentacioni hartografik dhe situata tekniko-ligjore në raport me dokumentin kadastral të pronësisë dhe planvendosjen që shoqëron vërtetimin gjyqësor të faktit nuk krijojnë bindjen për pozicionimin e saktë të pronës. Ky vendim i AKKP-së është bërë objekt i shqyrtimit të procesit gjyqësor të kundërshtuar.

32. Konkretisht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur anulimin e vendimit të AKKP-së dhe njohjen e së drejtës së pronësisë subjektit të shpronësuar Z.Q. për sipërfaqen e pretenduar. Sipas



asaj gjykate, sipas vërtetimit kadastral nr. 2546/1 prot., datë 18.7.2011 të SAMT-së, Këshilli i Qarkut Tiranë, shtetasi Z.Q., para zbatimit të ligjit nr. 108/1945, ka pasur në pronësi 73.000 m², me vendndodhje në fshatin Qeha, Komuna Petrelë, Tiranë. Gjykata ka arsyetuar se ligji nr. 9235/2004 dhe aktet e tjera nënligjore nuk parashikojnë si kusht për njohjen, kthimin apo kompensimin përputhjen ose jo të zërit kadastral të pronës së pretenduar me të dhënat “kufitare” dhe se fakti se zëri kadastral “pyll”, “arë”, “livadh”, “pemëtores” para vitit 1944 nuk rezulton i tillë edhe në vitin 2011, nuk përbën shkak për moskthimin e pronës tek i zoti. Ajo ka arsyetuar, gjithashtu, se e dhëna “kufitare”, në kuptim të ligjit material dhe akteve nënligjore, përbën kusht për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës së pretenduar në funksion të pozicionimit të saj. Ky element rezulton të jetë plotësuar me vendimin nr. 1826, datë 9.3.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili përbën provë të plotë e të pakundërshtueshme në përcaktimin e të dhënës së munguar në dokumentin ligjor të origjinës së pronës (*shih faqet 5, 6 dhe 7 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor*). Gjithashtu, në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes gjykata ka marrë edhe mendimin e një eksperti, sipas të cilit kufijtë e përcaktuar me vendimin për vërtetimin gjyqësor të faktit përputhen, nga njëra anë, me kufijtë natyrorë të pasurive të pretenduara, pasqyruar në fragmentet e hartave të viteve 1937 dhe 1980 dhe, nga ana tjetër, me pretendimet e paditësve mbi vendndodhjen në terren të pronave (*shih faqet 7 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

33. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 3537, datë 27.10.2014, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke e gjetur të drejtë atë, me arsyetimin se u ka dhënë përgjigje pretendimeve të palëve, pasi ka analizuar faktet dhe provat në bazë të dispozitave ligjore të zbatueshme. Edhe kjo gjykatë për njohjen e së drejtës së pronësisë të subjektit të shpronësuar Z.Q. dhe në funksion të pozicionimit të saj, është bazuar në vërtetimin kadastral nr. 2546/1 prot., datë 18.7.2011 të SAMT-së, Këshilli i Qarkut Tiranë, si dhe në vendimin nr. 1826, datë 9.3.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*shih faqet 13 dhe 14 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

34. Kolegji Civil ka vendosur ndryshimin e vendimeve të mësipërme të të dyja shkallëve të gjykimit dhe rrëzimin në themel të kërkesëpadisë,

pasi pala paditëse nuk gëzon legjitimitet aktiv substancial për të kërkuar njohjen, kthimin, kompensimin ose trajtimin e pronës të trashëgimlënësit si ish-pronar, pasi ai nuk ka pasur të drejta pronësie para datës 29.11.1944 të dokumentuara në përputhje me legjislacionin në fuqi (*shih paragrafin 50 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Gjykata konstaton se për të arritur në këtë përfundim ai kolegji ka rivlerësuar secilën prej provave të paraqitura prej kërkuarës në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe të vlerësuar nga gjykatat e faktit.

35. Kështu, sipas arsyetimit të Gjykatës së Lartë, shkresa nr. 2678/3 prot., datë 29.5.2008 e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave përbën një vetdeklarim të personave të interesuar për përfitim kredie dhe se nuk ka vlerën e provës lidhur me të drejtën e pronësinë së pretenduar mbi sipërfaqen bujqësore (*shih paragrafin 43 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Nga ana tjetër, Kolegji Civil ka vlerësuar se në aspektin formal, në dokumentin bashkëlidhur kësaj shkrese, dallohet dukshëm që ka ndërhyrje tek emri i nënshkruesit dhe se këto pasaktësi të konstatuara janë të natyrës së përcaktuar në nenin 246 të KPC-së, kështoj dokumenti ka të korrigjuar emrin e personit (*shih paragrafët 44, 45 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Më tej, Kolegji Civil ka vlerësuar edhe vërtetimin nr. 2546/1 prot., datë 18.7.2011 të SAMT-së, Këshilli i Qarkut Tiranë, duke arsyetuar se atij vërtetimi nuk i bashkëlidhet dokumentacioni shoqërues, pra kopje e njëzuar me origjinalin e regjistrit nga i cili janë marrë të dhënat dhe se vetë SAMT-ja, Këshilli i Qarkut Tiranë nuk ka konfirmuar të dhënat në këtë shkresë (*shih paragrafin 47 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në vendimin e kundërshtuar, gjithashtu, është vënë në dyshim edhe vlera e vendimit gjyqësor për vërtetimin e faktit të vendndodhjes dhe kufijtë e sipërfaqes së tokës 73.000 m², të ndodhur në fshatin Qeha. Sipas Kolegjit Civil, ky vendim nuk mund të konsiderohet se ka zgjidhur në themel pretendimet e palëve ose edhe të personave të cilët pretendojnë të drejta pronësie, duke qenë se procesi nuk është zhvilluar me praninë e palëve (*shih paragrafët 48-49 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

36. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vëren se si gjatë hetimit administrativ të kërkesës në AKKP, ashtu edhe gjatë procesit gjyqësor në dy shkallët më të ulëta të gjykimit, provat e paraqitura nga pala paditëse janë analizuar në kuptim të pozicionimit të



pasurisë për të cilën kërkohet njohja e së drejtës së pronës, pa vënë në dyshim legjitimitetin substancial aktiv të subjektit të shpronësuar (trashëgimlënësit të paditësve). Ndërsa Kolegji Civil ka analizuar edhe një herë këto prova në drejtim të provueshmërisë të së drejtës së pronësisë së kërkuesit, pra të legjitimitetit substancial aktiv të tij, duke nxjerrë konkluzione të ndryshme mbi faktet e mosmarrëveshjes.

37. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar ka ripërcaktuar faktet e çështjes në lidhje me njohjen e së drejtës së pronësisë së kërkuesit. Ndonëse funksioni kushtetues i Gjykatës së Lartë është ai i gjykatës së ligjit, në rastin konkret ajo ka ndryshuar vendimet e gjykatave të faktit dhe është shprehur për themelin e çështjes, duke mos u bazuar në mënyrën e zbatimit të ligjit nga këto gjykata, por duke bërë vlerësim të ndryshëm të provave mbi të cilat dy gjykatat më të ulëta kanë arritur në përfundimin për njohjen e së drejtës së pronësisë së kërkuesit. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se nëse Gjykata e Lartë kishte dyshime në lidhje me provueshmërinë e së drejtës së pronësisë së trashëgimlënësit të paditësve, ajo duhej ta kthente çështjen për rishqyrtim në gjykatat e faktit, duke dhënë udhëzimet përkatëse, në mënyrë që në përputhje me kompetencat e tyre ligjore për shqyrtimin e provave dhe përcaktimin e fakteve të arrinin në një konkluzion të plotë për çështjen, duke ia nënshtuar provat e administruara hetimit gjyqësor.

38. Për sa më lart, Gjykata e Lartë jo vetëm që ka nxjerrë konkluzion për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të faktit, duke bërë edhe vlerësim të mëtejshëm të tyre, i cili nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në atë gjykatë, por edhe nuk ka arsyetuar nëse ky vlerësim është bërë në funksion të interpretimit të ligjit, çka hyn në atributin e saj kushtetues. Për pasojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është i bazuar.

39. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj është i bazuar, sipas arsyesimit të mësipërm, ndaj dhe kërkesa e tij duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1907 (285), datë 12.7.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 14.9.2023.

Shpallur, më 11.10.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Elsa Toska, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Marjana Semini

VENDIM

Nr. 1, datë 9.10.2023

PËR SHPALLJEN E KANDIDATËVE FITUES PËR ANËTARË GJYQTARË TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Në mbështetje të pikës 7, të nenit 17, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Komisioni i Votimit, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i përbërë nga anëtarët:

Alda Sadiku – kryetare;

Engjëllushe Tahiri – anëtare;

Sonila Hoxha – anëtare,

bazuar në rezultatet e votimit për zgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas procesverbalit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij,



VENDOSI:

1. Të shpallë emrat e kandidatëve fitues për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si vijon:

1) Emona Muçi shpallet fitues për Gjykatën e Apelit;

2) Gentjana Muçaj shpallet fitues për Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë;

3) Markelian Koça shpallet fitues për Gjykatën e Shkallës së Parë jashtë Tiranës.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 5 (pesë) ditëve, duke nisur ky afat nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I VOTIMIT

Kryetare: Alda Sadiku

Anëtare: Engjëllushe Tahiri, Sonila Hoxha

KËRKESË

Nr. 360/12, datë 12.10.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 657, datë 8.10.2014, për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të

paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Qukës–Pogradec–Qafa e Plloçës’, i ndryshuar”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “dru frutor”, vlerësimi i të cilave është kryer bazuar në udhëzimin nr. 1, datë 5.10.2000, sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Autoritetin Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1 109 185 (një milion e njëqind e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Egra Ibrahim



LISTA EMËRORE PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “QUKËS–POGRADEC–QAFA E PLLOÇËS”, PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VKM-NË NR. 657, DATË 8.10.2014, I NDRYSHUAR

Nr.	PRONARI						Të dhëna (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				Shpronësim	Vlera totale (lek)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Adresa e pasurisë	Rrethi	Indeksi i hartës	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pas.	Sipërfaqe totale	Vlera, lek – dru frutorë (Drejtoria e Bujqësisë Lushnjë)		
1	Zeliha Brisilda Eliverta Jonida	Xhevit Fari Fari Fari	Qose Hoxha Tola Qose	Trebinje	Pogradec	PG-34-114-(50-D)	3627	27/12	Dru frutor	1872	1109185	1109185	Konfirmuar nga ASHK-ja, Pogradec
TOTALI											1,109,185	1,109,185	

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 432 lekë